



STUDIM

ÇËSHTJE TË RRRITJES SË EFEKTIVITETIT, TRANSPARENCËS DHE TË BESIMIT TË PUBLIKUT NË GJYQËSOR

Rezultate të nxjerra nga monitorimi i seancave dhe studimi i jurisprudencës gjyqësore në lidhje me mbrojtjen e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, në rrethet gjyqësore Tiranë, Elbasan, Shkodër, Vlorë.

Periudha e monitorimit: Shkurt 2012 - Tetor 2013

Ky botim u realizua me mbështetjen e popullit amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Autorët mbajnë përgjegjësi të plotë për brendinë e botimit, e cila nuk përfaqëson domosdoshmërisht pikëpamjet e USAID-it apo të qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

Tiranë, 2013

ÇËSHITJE TË RRITJES SË EFEKTIVITETIT, TRANSPARENCËS DHE TË BESIMIT TË PUBLIKUT NË GJYQËSOR

Ky studim u hartua në kuadrin e zbatimit të projektit: *“Forcimi i sistemit të transparencës, efektshmërisë dhe paanshmërisë në gjykatat shqiptare, përmes përmirësimit të cilësisë së përfaqësimit në gjykim dhe rritjes së aftësisë së shoqërisë civile në monitorimin dhe adresimin e këtyre çështjeve”*, i zbatuar nga Qendra për Nisma Ligjore dhe Qytetare, Forumi i Gruas Elbasan dhe Shoqata “Gruaja tek Gruaja”, Shkodër, me financimin e Programit të USAID-it për Forcimin e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri (JuST)

Hartoi Raportin:

Prof. Dr. Av. Aurela Anastasi (*Akademike e Asociuar*)

Përgatitën të dhënat:

Av. Aurela Bozo, Av. Iris Aliaj, Av. Jonida Gezka, Av. Besa Saraçi, Av. Emirtela Aliaj, Av. Edlira Grabova, Av. Soela Kurti, Av. Teuta Hoxha.

C. Qendra për Nisma Ligjore Qytetare

Adresa: Rr. Vaso Pasha, Pall.12., Shk.1., Ap.1., Tiranë-Shqipëri.

Tel: +35542241914, 2259795

Email: avokatore@albmail.com, avokatore2@yahoo.com

Website: www.qag-al.org

PËRMBAJTJA E LËNDËS

Falenderime

Lista e shkurtimeve

I. OBJEKTI DHE METODOLOGJIA E PUNËS----- 6

- 1. Objekti dhe qëllimi i monitorimit. Pse nevojitet ky studim?*
- 2. Metodot dhe radha e punës.*
- 3. Burimet Ligjore.*
- 4. Kufizime.*
- 5. Pika të forta.*

II. “GJYKATË E PAANSHME” SI PARIM KUSHTETUES, PËR NJË GJYQËSOR TË FORTË DHE TË BESUESHËM-----12

- 1. Kuptimi i parimit kushtetues “gjykatë e paanshme”. Jurisprudenca Ndërkombëtare e kombëtare.*
- 2. Të dhëna dhe mësim nga monitorimi i rasteve në gjykatë mbi perceptimin e paanshmërisë.*
- 3. Perceptimi i paanshmërisë në gjykim nga vetë gjyqtarët. Administrimi i institutit të heqjes dorë të gjyqtarit nga gjykimi i çështjes konkrete, me qëllim moscenimin e thelbit të drejtësisë.*
- 4. Përmbledhje e konkluzioneve dhe sugjerimeve.*

III. E DREJTA PËR TË KËRKUAR DREJTËSI (AKSESI) NË GJYKATË-----33

- 1. Standardet ligjore e jurisprudenciale të vendosura në nivel ndërkombëtar e kombëtar.*
- 2. Gjetjet nga procesi i monitorimit.*
- 3. Cilat janë mekanizmat dhe mundësitë që ofron legjislacioni shqiptar për t’u përjashtuar nga këto pagesa?*
- 4. E drejta për të marrë njoftim ose për t’u thirrur për fillimin e seancës gjyqësore.*

IV. EFEKTIVITETI I PROCESIT GJYQËSOR	46
1. <i>Kohëzgjatja e gjykimeve në çështjet me objekt Zgjidhje Martese, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë.</i>	
2. <i>Kohëzgjatja në çështjet me objekt UM dhe UMM.</i>	
3. <i>Shkaqet e shtyrjes së seancave gjyqësore.</i>	
V. SOLEMNITETI DHE SJELLJA E GJYQTARIT GJATË SEANCAVE GJYQËSORE	60
1. <i>Solemniteti i seancave gjyqësore.</i>	
2. <i>Etika profesionale.</i>	
3. <i>Përdorimi i njohurive dhe gjuhës juridike.</i>	
VI. PËRMBLEDHJE E SUGJERIMEVE KRYESORE	72
BIBLIOGRAFIA	75

Falenderime,

Ky punim u bë i mundur në saje të bashkëpunimit të organizatave Qendra për Nisma Ligjore Qytetare me Forumin e Gruas, Elbasan dhe Shoqatën “Gruaja tek Gruaja”, Shkodër. Falenderojmë, Znj. Shpresa Banja dhe Znj. Majlinda Angoni, si dhe avokatet e tria organizatave për punën dhe ndihmesën e tyre në përmbushjen e tij.

Një falënderim i veçantë u drejtohet studentëve të skuadrës *pro bono* që realizuan monitorimin: Anxhela Gllavina, Entiola Braka, Borana Ismaili, Mestjona Banushaj, Suada Cara, Zaim Lakti, Iris Spahiu, Griselda Muca, Elba Arapi, Sonila Samurri, Alban Gjilani, Nertil Dushku, Agim Gapi, Ledia Lahi, Elisabeta Gjoni, Arjola Azizaj, Elton Zeneli, Krisi Anastas, **në Tiranë**; Griselda Muça, Iris Spahiu, Elba Arapi, Ornela Ferhati, Anxhela Gllavina, **në Elbasan**; Romina Kali, Kristi Kola, Griselda Dama, Alfons Pecaj, Sindi Kola dhe Irena Guri, **në Shkodër**.

Vërejtjet dhe sugjerimet e paraqitura nga përfaqesuesit e grupeve të interesit dhe të institucioneve publike, kanë ndihmuar mjaft në përmirësimin e raportit. Për këtë, falenderojmë të gjithë pjesëmarrësit në tryezat për diskutimin e gjetjeve të studimit dhe në mënyrë të veçantë: Prof. Dr. Marjana Semini, Prof. As. Dr. Flutura Tafaj, Dr. Arta Vorpsi, Znj. Manjola Bejleri, Znj. Hajrie Muçmata dhe Znj. Vojsava Osmanaj.

Së fundi, një falënderim i përzemërt i drejtohet Programit për Forcimin e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri, (JuST), që dha ndihmesë jo vetëm si donator, por edhe si një partner, për realizimin e këtij projekti, gjatë të cilit ia dolëm mbanë që përveç këtij studimi, të ofrojmë edhe ndihmën ligjore falas për 340 gra dhe vajza në nevojë, gjatë periudhës dyvjeçare 2012-2013.

Ju faleminderit të gjithëve për bashkëpunimin!

Ju urojmë një lexim të dobishëm!

Prof. Dr. Av. Aurela Anastasi
Drejtoresh Ekzekutive
Qendra për Nisma Ligjore Qytetare

Lista e Shkurtimeve:

KLD-Këshilli i Lartë i Drejtësisë

QNL- Qendra për Nisma Ligjore Qytetare

UM- Urdhri i Mbrojtjes

UMM- Urdhri i Menjëhershëm i Mbrojtjes

LDHF-Ligji kundër dhunës në familje

I. OBJEKTI DHE METODOLOGJIA E PUNËS.

1. Objekti dhe qëllimi i monitorimit. Pse nevojitet ky studim?

Raporti studimor që po paraqesim, parashtron disa nga rezultatet dhe gjetjet nga monitorimi e seancave dhe studimi i jurisprudencës gjyqësore me qëllim dhënien e ndihmesës sonë për rritjen e efektivitetit, të transparencës dhe besimit të publikut ndaj gjykatave, në çështjet që lidhen me mbrojtjen e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit.

Ky raport është hartuar në kuadrin e projektit: ***“Forcimi i sistemit të transparencës, efektshmërisë dhe paanshmërisë në gjykatat shqiptare, përmes përmirësimit të cilësisë së përfaqësimit në gjykim dhe rritjes së aftësisë së shoqërisë civile në monitorimin dhe adresimin e këtyre çështjeve”***, që QNL zbatoi me mbështetjen e Programit për Forcimin e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri (JuST), në periudhën Janar 2012-Dhjetor 2013. Në këtë projekt, aktiviteti i monitorimit të seancave gjyqësore u krye në krah të disa aktiviteteve të tjera për të ofruar shërbimet ligjore falas për viktimat e dhunës në familje, viktimat e diskriminimit për shkak të gjinisë ose për shkaqe të tjera, si dhe për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore. E gjithë veprimtaria për realizimin e këtij projekti u krye në rrjet, Nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, në partneritet me Shoqatën “Gruaja tek gruaja” dhe organizatën “Forumi i Gruas Elbasan”.

Në kuadrin e zbatimit të projektit, fokusi i monitorimit në seancat gjyqësore ishte kryesisht, sjellja e gjyqtarit dhe e gjykatës në lidhje me zbatimin e parimeve të paanshmërisë, eksedit në drejtësi dhe efektivitetit të gjykatës si dhe disa aspekte të tjera të së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Puna synoi krijimin e një kontributi të dobishëm që Qendra jonë, si një qendër e shërbimit ligjor falas, duhet të japë për rritjen e efektivitetit, besueshmërisë dhe transparencës së gjyqësorit.

Kontributi ynë fokusohet në një numër të kufizuar çështjesh, të cilat i përkasin ose lidhen me zbatimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, veçanërisht për shkak të gjinisë. Kështu,

vëmendja jonë u adresua kryesisht, në çështjet me objekt urdhrat e mbrojtjes (UM dhe UMM), zgjidhjet e martesave, konfliktet në punë, si dhe në disa çështje të tjera civile e penale.

Ky studim nevojitet për njohjen e praktikave të gjykatës dhe zbatimin prej saj të rregullave të deontologjisë dhe të etikës gjyqësore, me qëllim që të kontribuojmë nga jashtë në përmirësimin e tyre. Kjo do të ndihmonte në përmirësimin e cilësisë dhe të transparencës për dhënien e drejtësisë, në rritjen e efektivitetit të gjykimit, në përmirësimin e perceptimit të publikut për gjykatën, si një gjykatë e paanshme dhe transparente, me qëllim rritjen e besueshmërisë së tij ndaj saj. Nga ana tjetër, marrja në konsideratë e gjetjeve dhe rezultateve të këtij monitorimi do të ndihmonte në respektimin e disa aspekteve të rëndësishme të së drejtës së personave për të pasur akses në drejtësi dhe një proces të rregullt ligjor. Ky studim parashtroi detyra të qarta edhe për institucionet e tjera shtetërore si dhe për OJF-të, me qëllim forcimin e këtyre komponentëve në procesin gjyqësor.

2. Metodat dhe radha e punës.

Studimi që po paraqesim u mbështet në punën monitoruese të seancave gjyqësore të kryera nga studentët e drejtësisë nën drejtimin e avokatëve monitorues për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Shkodër, Elbasan, Vlorë dhe në monitorimin e vendimeve gjyqësore, të kryer nga avokatët e Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare.

Stafi i projektit i kushtoi rëndësi të veçantë punës përgatitore për kryerjen e monitorimit. Përgatitja për monitorim nisi me ngritjen e grupit të ekspertëve, të cilët u përzgjedhën nga radhët e avokatëve dhe ekspertëve me përvojë në monitorime që lidhen me transparencën, efektivitetin dhe paanshmërinë e gjyqësorit. Grupi i përzgjedhur i ekspertëve luajti një rol të rëndësishëm, jo vetëm në hartimin e skedës së monitorimit, por edhe gjatë gjithë zbatimit të projektit, duke ndjekur hap pas hapi kryerjen e monitorimit në kohë, me cilësi dhe profesionalizëm. Fillimisht, ai përgatiti një skedë dhe një plan monitorimi pranë gjykatës. Gjithashtu, u përgatit një plan trajnimi për anëtarët e skuadrave *pro bono*, studentë të Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, si dhe një plan bashkëpunimi me Klinikën e Ligjit pranë Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës. Studentët e Fakultetit të Drejtësisë së këtij universiteti u trajnuan me qëllim pjesëmarrjen e tyre në monitorim. Studentët monitorues krijuan eksperiencë edhe përmes pjesëmarrjes në mbledhjet e rregullta të avokateve të Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare,

përgatitjes së kërkesave për UMM, UM, kërkesë padive për çështje familjare, konflikte pune, çështje të barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit, si dhe përmes pjesëmarrjes në seancat gjyqësore. Kjo eksperiencë i ndihmoi ata për bashkëpunimin në kryerjen e monitorimit, me avokatët e QNL-së dhe avokatët monitorues për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, Elbasan, Vlorë.

Numri i seancave gjyqësore të monitoruara për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në total është 105 seanca gjyqësore, nga 80 seanca të parashikuara në projekt për t'u monitoruar. Konkretisht, u monitoruan 32 seanca gjyqësore (ose 30.4% të seancave të monitoruara) për çështjet me objekt lëshimin e UMM/UM; 29 seanca gjyqësore (ose 27.6% të seancave të monitoruara) për çështjet me objekt zgjidhje martese; 13 seanca gjyqësore (ose 12.3% të seancave të monitoruara) për çështjet civile me objekt kërkim sendi, pavlefshmeri kontrate shitjeje, hipoteke dhe huaje, shpërblim dëmi, pagim i shpenzimeve të kryera, çelje e dëshmisë së trashëgimisë, kontratë sipërmarrjeje, etj; 6 seanca (ose 5.7% të seancave të monitoruara) për çështje të tjera familjare me objekt vërtetim atësie, vërtetim i faktit juridik të lindjes së fëmijës, heqje e përgjegjësisë prindërore, kujdestarie, rivendosje në afat të vërtetimit të atësisë; 20 seanca (ose 19% të seancave të monitoruara) për çështje me objekt konflikte pune, diskriminimi dhe çështje të barazisë gjinore; 5 seanca (ose 4.7% të seancave të monitoruara) të çështjeve penale me objekt thyerje të UM/UMM, kryerjen e veprimeve në kundërshtim me vendimin e gjykatës, në lidhje me detyrat e lindura nga urdhrat e mbrojtjes të dhëna prej saj, si dhe “Goditje dhe fyerje për shkak të detyrës”.

Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, numri i seancave gjyqësore të monitoruara në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, në total është 69, nga 60 seanca gjyqësore, të parashikuara në projekt për t'u monitoruar. Janë monitoruar 14 seanca gjyqësore (ose 20.2 % e seancave të monitoruara) për çështjet me objekt lëshimin e UMM/UM; 19 seanca gjyqësore (ose 27.5 % e seancave të monitoruara) për çështjet me objekt zgjidhje martese; 18 seanca gjyqësore (ose 26 % e seancave të monitoruara), për çështjet familjare me objekt detyrim ushqimor ndaj fëmijëve të mitur dhe 18 seanca (ose 26 % e seancave të monitoruara) me objekt kujdestari për fëmijën.

Edhe në Gjykatën e rrethit gjyqësor Elbasan numri i seancave të monitoruara në total është 142, nga 60 të parashikuara në projekt për t'u monitoruar. Nga këto, 88 raste ose 61.9% janë seanca të monitoruara për çështjet me objekt “Zgjidhje Martese”; 1 rast ose 0.7% është seancë e monitoruar për çështjen me objekt “Ndryshim kujdestarie”; 4 raste ose 2.8% janë seanca të

monitoruara për çështjet me objekt “Caktimin e pensionit ushqimor”, 20,4% përbëjnë seancat e monitoruara për çështjet me objekt lëshimin e UMM/UM, seancat e monitoruara për çështjet civile zënë 11,9% dhe janë monitoruar 3 seanca ose 2,1% për çështjet penale me objekt “Mosdhënie e mjeteve për jetesë”.

Në gjykatën e rrethit gjyqësor Vlorë, janë monitoruar 10 seanca gjyqësore, siç është parashikuar në projekt propozim. Janë monitoruar 6 seanca gjyqësore për çështje familjare me objekt zgjidhje martese, ushtrimin e përgjegjësisë prindërore dhe caktimin e detyrimit ushqimor për fëmijët, 1 seancë gjyqësore për çështjen me objekt pjesëtimin e pasurisë bashkëshortore, 2 seanca gjyqësore për çështje me objekt lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes/urdhrit të mbrojtjes dhe 1 seancë gjyqësore për çështjen penale.

Skeda monitoruese përfshin çështje që lidhen me vëmendjen e gjyqtarit ndaj procedurave dhe pjesëmarrësve, me veprimet e gjyqtarit që krijojnë perceptimin për njëanshmëri në proces, në etikën e gjyqtarit dhe etikën e palëve në proces, etj. Gjithashtu, ajo përfshin pyetje specifike në lidhje me zbatimin e parimit të transparencës, efektshmërisë dhe paanshmërisë në gjykatat shqiptare në çështjet familjare, konfliktet e punës dhe diskriminimit, si dhe gjykimin e çështjeve për lëshimin e urdhrave të mbrojtjes.

Për përcaktimin e çështjeve nën monitorim, në gjykatat e rretheve gjyqësore objekt monitorimi, grupi i ekspertëve u mbështet edhe në problematikën e identifikuar nga përvoja e deritanishme e koalicionit të përbërë nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, Forumi i Gruas Elbasan dhe Gruaja tek Gruaja Shkodër. Monitorimi u mbështet edhe në problematikat e ngritura drejtpërsëdrejti nga klientet, përfituese të shërbimeve ligjore të ofruara nga tre organizatat zbatuese të projektit.

Ofrimi i ndihmës ligjore falas gjatë zbatimit të projektit ka shërbyer jo vetëm për rritjen e aksesit të qytetarëve në sistemin e drejtësisë, por ka përbërë një mjet të rëndësishëm për të monitoruar se sa të efektshme, transparente dhe të paanshme janë gjykatat e rretheve gjyqësore Tiranë, Shkodër, Elbasan, Vlorë, gjë që na bën të arrijmë në konkluzionet e duhura për tërësinë e sistemit të drejtësisë. Përmes ofrimit të shërbimit ligjor janë evidentuar problematika të cilat kanë shërbyer për formulimin e rekomandimeve të rëndësishme, në lidhje me transparencën, efektivitetin dhe paanshmërinë e gjyqësorit.

Përdorimi i të njëjtës skedë monitoruese nga avokatet monitoruese dhe studentët monitorues në gjykatat e rretheve gjyqësore objekt monitorimi na ka ofruar mundësinë për krahasimin e gjetjeve.

Skeda monitoruese është plotësuar me të dhëna nga vëzhgimi i kryer nga avokatja mbikqyrëse dhe studentët monitorues në sallën e gjyqit. Të dhënat që rezultuan nga monitorimi u përpunuan nga një ekspert për përpunimin e të dhënave, i angazhuar në projekt.

Rezultatet e monitorimit do të diskutohen me profesionistët e sistemit gjyqësor në gjykatat e Rretheve Gjyqësore Tiranë, Shkodër, Elbasan dhe Vlorë dhe do të shërbejnë si një mjet lobimi dhe promovimi i transparencës, efektivitetit dhe paanshmërisë në gjykatat shqiptare.

3. Burimet Ligjore.

Për kryerjen e këtij studimi, kryesisht, u mbështetëm në burimet ligjore që vijnë:

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 42, 142/1
2. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
3. Kodi i Familjes së RSH
4. Kodi i procedurës Civile të RSH
5. Kodi i Procedurës Penale të RSH
6. Kodi i Etikës gjyqësore, dt. 05.12.2000
7. Sistemi i vlerësimit profesional dhe etik i gjyqtarëve dhe Vendimi i KLD-së Nr.199/3, dt. 15.09.2006, “Mbi kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”.

Gjithashtu, një ndihmesë të madhe na ka dhënë studimi i Jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe i Gjykatës Kushtetuese të RSh.

- 4. Kufizime.** Konceptet që u monitoruan janë të vështira dhe kërkojnë njohuri shumë të thelluara. Kjo krijoi kufizime në perceptimet e monitoruesve.

Skeda dhe plani i monitorimit u përgatitën me kujdes, sipas mundësive që ofroheshin dhe në përputhje me kapacitetet e monitoruesve. Por, mesatarisht, në rreth 20% të skedave, monitoruesit nuk kanë arritur të plotësojnë përgjigje për disa nga pyetjet. Në shumicën e rasteve, kjo ka ndodhur se seancat nuk janë zhvilluar, ose janë çelur formalisht dhe gjykimi është shtyrë.

Gjithashtu, nga 105 seanca të monitoruara, në 10 raste, monitoruesit nuk u lejuan të monitoronin nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

Një pikë të dobët përbën edhe fakti se, gjatë punës sonë, ka pasur ndryshime të bazës ligjore. Kështu, p.sh., në 25 Dhjetor 2012, ka hyrë në fuqi Udhëzimi i Përbashkët Nr. 5668, dt. 20.11.2013 “Për një ndryshim në Udhëzimin Nr. . nr. 13, datë 12.2.2009 ”*Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për veprime dhe shërbime të administratës gjyqësore, ministrisë së drejtësisë, prokurorisë, Noterisë dhe Zyrës së Regjistrimit të pasurive të paluajtshme*”, të ndryshuar. Ky udhëzim ka parashikuar tarifa të reja gjyqësore të cilat janë dukshëm zbritëse në raport me tarifat e përcaktuara nga udhëzimi i mëparshëm, por që sidoqoftë, kanë nevojë të diskutohen. Ndërkohë të gjitha analizat tona në këtë punim, janë kryer mbi bazën e përvojës së vendosur me Udhëzimin Nr. . nr. 13, datë 12.2.2009, mbi tarifat e shërbimit të gjykatave.

5. Pika të forta. Monitorimi dhe nxjerrja e konkluzioneve nga praktika e ndihmës ligjore, të ofruar nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare Tiranë, Forumi i Gruas Elbasan dhe Shoqata Gruaja tek Gruaja Shkodër, krijoi mundësinë që të verifikohen gjetjet e përpunuara nga skedat monitorimit.

Kanë ndihmuar procesin:

- Puna në grup midis studentëve dhe avokatëve monitorues të organizatave.
- Konsultimi i gjetjeve midis të tria organizatave zbatuese të projektit.
- Aftësitë e stafit të projektit në çështjet kushtetuese dhe gjinore.
- Krahasimi i gjetjeve nga të tria organizatat zbatuese.
- Tërheqja e mendimit të institucioneve të monitoruara dhe institucioneve të tjera.
- Shfrytëzimi i literaturës ekzistuese të monitorimit të gjykatave.
- Përqendrimi i këtij monitorimi në çështjet gjinore.

II. “GJYKATË E PAANSHME” SI PARIM KUSHTETUES, PËR NJË GJYQËSOR TË FORTË DHE TË BESUESHËM

Respektimi i këtij parimi mbetet një nga aspektet thelbësore të procesit të rregullt ligjor dhe të parandalimit të konfliktit të interesit në organet e dhënies së drejtësisë. Prandaj, synimi i këtij punimi është që të analizojë disa aspekte të parimit “gjykatë e paanshme”, me qëllim që të nxjerrim mësimet dhe konkluzionet e duhura për efektivitetin në zbatimin e tij. Metoda e analizës është bazuar në evidentimin e standardeve ndërkombëtare për kuptimin dhe zbatimin e këtij parimi, kryesisht, përmes jurisprudencës së GJEDNJ-së dhe akteve të tjera ndërkombëtare. Këto standarde janë krahasuar me rezultatet e nxjerra nga monitorimi i Jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë në dy vitet e fundit; nga monitorimi i 105 seancave gjyqësore të zhvilluara në dy vitet e fundit pranë gjykatës së shkallës së parë, Tiranë, kryesisht, në çështje me objekt zgjidhjen e konflikteve në marrëdhëniet familjare e ato të punës; si dhe nga monitorimi i rasteve të dorëheqjeve të gjyqtarëve nga gjykimi i çështjeve konkrete, me objekt zgjidhjen e konflikteve familjare, pranë Gjykatës së Shkallës I-rë Tiranë, për vitin 2013¹.

Vitet e fundit, në kuadrin e ankimeve për një proces të rregullt ligjor, konstatojmë një rritje të kërkesave drejtuar Gjykatës Kushtetuese, me pretendimin se është shkelur parimi i paanshmërisë së gjyqtarit. Në një vështrim të shpejtë, vëmë re se, vetëm në gjashtëmujorin e parë të vitit 2013, Gjykata Kushtetuese ka gjykuar 4 çështje mbi paanshmërinë e gjykatës. Ajo ka vendosur shfuqizimin e pjesshëm të nenit 75 të Kodit të Procedurës Civile, pasi e ka konsideruar antikushtetuese *shqyrtimin e kërkesës për përjashtimin e gjyqtarit në seancë, nga i njëjti trup gjykues që gjykon çështjen (Vendim i GJK nr. 11/2013)*², siç ishte sanksionuar në këtë nen.

Edhe në procesin gjyqësor të zakonshëm, paraqiten vazhdimisht kërkesa të palëve për përjashtimin e gjyqtarit nga gjykimi i çështjes dhe anasjelltas, ka mjaft kërkesa të gjyqtarëve që heqin dorë nga gjykimi i një çështjeje konkrete. Kështu p.sh., në 6 mujorin e parë të vitit 2013,

¹ Monitorimi është kryer nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare me mbështetjen e programit “Për forcimin e sistemit të Drejtësisë në Shqipëri” (JuST), në kuadrin e projektit “*Forcimi i sistemit të transparencës, efektshmërisë dhe paanshmërisë në gjykatat shqiptare, përmes përmirësimit të cilësisë së përfaqësimit në gjykim dhe rritjes së aftësisë së shoqërisë civile në monitorimin dhe adresimin e këtyre çështjeve*”.

² Përgjatë gjithë vitit 2012 Gjykata Kushtetuese gjykoi 3 çështje në lidhje me këtë objekt, ndërkohë që gjatë vitit 2011, kishte gjykuar gjithsej, 7 çështje.

vetëm në çështjet me objekt urdhrat e mbrojtjes kundër dhunës në familje, pranë Gjykatës së Shkallës I-rë, Tiranë, ka pasur 6 kërkesa të gjyqtarëve për dorëheqje dhe 7 kërkesa në çështje të tjera me objekt zgjidhje të konflikteve në marrëdhëniet familjare.

Përpara se të njihemi me përpunimin e të dhënave që kanë dalë nga monitorimi, e shohim të dobishme të bëjmë paraprakisht një analizë teorike dhe jurisprudenciale për të kuptuar më mirë parimin e gjykatës së paanshme, si dhe zbatimin dhe ndikimin e tij në forcimin e pushtetit gjyqësor.

1. Kuptimi i parimit kushtetues “gjykatë e paanshme”. Jurisprudenca Ndërkombëtare e kombëtare.

1.1. Parimi “Gjykatë e paanshme” në kuptimin objektiv dhe subjektiv.

Për të kuptuar mirë këtë parim, në radhë të parë, duhet të eidentojmë paraqitjen e tij si një element thelbësor për të drejtën për një proces të rregullt ligjor (*neni 42 i Kushtetutës*). Si i tillë, ai ka qenë shpesh objekt shqyrtimi gjyqësor, prandaj një përkufizim të saktë mund ta gjejmë veçanërisht, në jurisprudencën gjyqësore. Për këtë, një ndihmesë të posaçme ka dhënë Jurisprudenca e GJEDNJ-së, ndërkohë që edhe Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë, në vijimësi, ka përsëritur të njëjtin qëndrim³. Ky qëndrim mund të përmbledhet shkurtimisht duke sjellë në vëmendje Josep Casadevall Medrano (Zv-kryetar i GJEDNJ), i cili e përkufizon si vijon “Gjykatën e paanshme”: “*Nocioni i Gjykatës së paanshme, në kuptimin e mungesës së paragjyimit ose të pozicionimit, nënkupton së pari, një analizë subjektive për të përcaktuar bindjen dhe sjelljen e gjykatësit në një çështje dhe pastaj, një analizë objektive që mundëson krijimin e garancive të mjaftueshme me qëllim që, personi që është subjekt i procesit të mund të shmangë çdo lloj dyshimi legjitim*”⁴. GJEDNJ-ja, ka evidentuar dallimin midis kriterit subjektiv dhe kriterit objektiv të paanshësisë. Në kuptimin subjektiv, paanshmëria e gjyqtarëve duhet të prezumohet, derisa të provohet e kundërta, kurse në atë objektiv, duhet të provohet, nëse ka fakte bindëse që vënë në dyshim paanshmërinë (*GJEDNJ, Driza kundër Shqipërisë, 2007*). Për këtë

³ Mbi zhvillimin e nocionit të paanshmërisë nga Gjykata Kushtetuese shqiptare, për vitet 1999-2010, shih: Sokol Sadushi, “Drejtësia Kushtetuese në zhvillim”, Tiranë, 2011, fq.641-644, Flutura Kola -Tafaj, “Pavarësia dhe paanshmëria e gjyqësorit”, në “Jeta Juridike”, Nr.1, mars, 2010, fq.101-113.

⁴ Shih: Josep Casadevall Medrano, “Gjykatë e pavarur dhe e paanshme”, kumtesë e mbajtur në Konferencën “Reforma gjyqësore, si një ndër 12 prioritetet e sfidës së integritetit të Shqipërisë në BE”, Tiranë, Korrik, 2012., fq.101.

arsye, respektimi i paanshmërisë verifikohet duke aplikuar dy testime: në testin subjektiv, shqyrtohet nëse ka elementë që vënë në dyshim objektivitetin dhe prezumimin e paanësisë në bindjen e brendshme të gjyqtarit për mënyrën e zgjidhjes së çështjes. Kurse, në kuptimin objektiv, shqyrtohet nëse gjyqtari ka ofruar garanci procedurale të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim të anshmërisë. P.sh., në çështjen *Driza kundër Shqipërisë*, GJEDNJ konsideroi si shkelje të paanësisë subjektive, faktin që, Kryetari i Gjykatës së Lartë, kishte filluar procedurat për parashtrimin e rekursit në interes të ligjit dhe më tej, kishte marrë pjesë në gjykimin e kësaj çështjeje si anëtar i trupit gjykues⁵. GJEDNJ-ja mendon se askush nuk mund të jetë në të njëjtën çështje, edhe paditës edhe gjyqtar (po aty). Kjo Gjykatë, në po të njëjtën çështje, konsideroi si shkelje të paanshmërisë objektive faktin që, në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, 6 nga 15 gjyqtarët, anëtarë të trupit gjykues, kishin gjykuar më parë të njëjtën çështje në themel dhe kishin dhënë vendimet përkatëse⁶.

Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese kryesisht, ka dhënë ndihmesën e saj në analizën e paanshmërisë objektive, parë që edhe kërkesat në këtë pikëvështrim kanë qenë më të shumta në numër. Ajo e ka konsideruar Gjykatë të njëanshme në kuptimin objektiv, trupin gjykues, kur në përbërjen e tij ka qenë i pranishëm qoftë edhe një gjyqtar i vetëm, i cili ka bërë një vlerësim të mëparshëm mbi të njëjtin fakt, pasi në këto kushte nuk konsiderohej se jepte garanci për një gjykim të paanshëm⁷. Këtë qëndrim ajo e ka saktësuar në disa vendime: “*Paragjykimi eventual për paanësinë e gjyqtarit mund të ngrihet edhe në dyshimin se gjyqtari është shprehur në një procedim tjetër me një vlerësim që ka të bëjë me **përmbajtjen e të njëjtut fakt, në lidhje me të njëjtin subjekt***” (Shih: vendimin nr. 15/2012 të Gjykatës Kushtetuese). Në të njëjtën kohë, Ajo ka rrëzuar kërkesat e palëve, të cilat nuk jepnin argumente të bazuara që të provonin se gjyqtari nuk ofronte garanci për një proces të paanshëm. Kështu p.sh., ka rrëzuar pretendimin për shkeljen parimit të paanshmërisë së gjykatës, për faktin se dy prej gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit që kishin dhënë vendimin, kishin qenë pjesë e trupit gjykues edhe në gjykimin që njohu dhe i dha fuqi vendimit të huaj në lidhje me këtë çështje. Gjykata arsyetoi se në këtë rast, këta gjyqtarë vlerësuan “*fuqinë detyruese të një vendimi gjyqësor të formës së prerë që përbën gjë të*

⁵ Shih: “*Driza kundër Shqipërisë*, 2007 (ankimi nr. 33771/02) botuar në gjuhën shqipe në “*Përmbledhje e vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut*”, Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare, nëntor 2009, fq.116.

⁶ Shih: Po aty.

⁷ Shih: Sokol Sadushi, Po aty, fq. 642.

gjykuar, brenda kufijve të përcaktuar nga ligji. Si një fakt objektiv ai nuk lë vend për diskrecion subjektiv, cilado qoftë përbërja e trupit gjykues”.Pra, në këtë rast, vendimi i një gjykate të një vendi të huaj është konsideruar si një burim fakt, dhe gjyqtarët kanë zbatuar thjesht mekanizmat për njohjen e tij, pa u shprehur për përmbajtjen.

Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese në tërësinë e saj i qëndron konform jurisprudencës së GJEDNJ-së, gjë që e ka bërë të duket më bindëse. Megjithatë, ajo ka treguar origjinalitetin e vet në mjaft raste, të cilat kanë nevojë për konsistencë të vazhdueshme. Kështu, p.sh., nuk më duket fort bindës arsyetimi i Gjykatës Kushtetuese, e cila nisur nga karakteristikat e shqyrtimit të rekursit në dhomë këshillimi, vlerëson se pretendimet e kërkuarit për cenimin e parimit të paanshmërisë, janë të pabazuara (*Vendimi i GJK, nr. 22/2013*). Në këtë rast, gjykata nuk e konsideron të njëjtën natyrë gjykimi, me gjykimin e çështjes në themel, prandaj nuk gjen vend për shkeljen e parimit të paanshmërisë në kuptimin objektiv. Ndërkohë kjo gjykatë, nuk e trajton fare faktin që, vendimi i trupës në dhomë këshillimi për mospranimin e rekursit ka natyrë përfundimtare dhe ka të njëjtin efekt me zgjidhjen e çështjes në themel. Kurse, në rastin e pretendimit të anshmërisë objektive për shkak të pjesëmarrjes së të njëjtit gjyqtar, si në dhënien e vendimit të ndërmjetëm për pezullimin e ekzekutimit të vendimit, ashtu edhe në dhënien e vendimit përfundimtar, Gjykata Kushtetuese ka arsyetuar se vendimi i ndërmjetëm nuk është një vendim përfundimtar, prandaj nuk e ka konsideruar shkelje të parimit të paanshmërisë pjesëmarrjen në trupë të të njëjtit gjyqtar (*Vendimi i GJK, nr. 22/2013*). Sidoqoftë në dhënien e një vendimi kjo gjykatë përdor disa testime dhe interpretime, të cilat e minimizojnë rrezikun për të dhënë një vendim të diskutueshëm.

1.2. Ndërveprimi i parimit “Gjykatë e paanshme” me parime të tjera.

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), ka vlerësuar se paanësia dhe pavarësia objektive janë ngushtësisht të lidhura, gjë që e ka shtyrë atë disa herë t’i shqyrtojë së bashku (*Brudnicka kundër Polonisë*)⁸. Studimi i këtij korrelacioni është i domosdoshëm për të realizuar mirë mbarëvajtjen dhe respektimin e të drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor. Edhe Kodi shqiptar i Etikës gjyqësore i ka lidhur ngushtë këto parime. Kreu i parë i këtij kodi i

⁸ Josep Casadevall Medrano, vep. cit., fq.99

konsideron pavarësinë dhe paanësinë si dy parime bazë të gjyqësorit, që garantojnë një gjykim të drejtë dhe të barabartë për të gjithë qytetarët⁹.

Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese shqiptare, e ka analizuar parimin gjykatë e paanshme të lidhur ngushtë me aspekte të tjera ndërvepruese. Kështu, Ajo e ka vënë theksin në paanësinë e gjykatës si një bashkëveprim me aspekte të tjera të mbarëvajtjes së pushtetit gjyqësor dhe të mirëfunksionimit të shtetit të së drejtës. Ajo ka shprehur qartë ndikimin që ky parim paraqet për “krijimin e besimit të qytetarëve tek gjyqësori” (GJK, vendimi nr.11/2013), duke e lidhur ngushtë me matjen e legjitimitetit të tij, pasi sipas Gjykatës, shkalla e besimit që ka publiku ndaj gjyqësorit, përbën një nga kriteret kryesore të këtij legjitimiteti. Përveç sa më sipër, Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë, sheh një ndërveprim të qartë të parimit të paanshmërisë në kuptimin e saj subjektiv, me të drejtën kushtetuese të palëve “që të jenë të përfshira aktivisht në vendimmarrjen” e drejtë, në kuadrin e procesit të rregullt ligjor. “Është e rëndësishme që në çdo fazë të procesit palët të jenë të përfshira aktivisht në vendimmarrje duke u dhënë atyre mundësinë për të paraqitur çështjen sipas këndvështrimeve të tyre, pa patur frikën se do të paragjykohej nga gjyqtari”. (GJK, vendimi nr. 11/2013).

Nga sa më sipër mund të gjykojmë se parimi “gjykatë e paanshme”, ndërvepron me një sërë çështjesh të tjera juridike, prandaj është e nevojshme të analizohet në korrelacion me konceptet e tjera shoqëruese. Vetëm kështu mund të kemi një dimension të vërtetë të kuptimit të këtij parimi, si dhe të ndikimit që ai ushtron në mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor.

1.3. Kuptimi i parimit “gjykatë e paanshme” si aspekt i parandalimit të korrupsionit në sistemin e drejtësisë.

Ka edhe një mënyrë tjetër për vështrimin e parimit “gjykatë e paanshme”. Zbatimi i tij lidhet ngushtë me parandalimin dhe luftimin e korrupsionit në gjyqësor. Një qasje e tillë buron nga vetë Kushtetuta, për aq sa Ajo sanksionon papajtueshmërinë e detyrës së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë dhe atij të Gjykatës Kushtetuese, me çdo veprimtari tjetër shtetërore, politike, ose private. Më tej, mund ta shohim atë të shoqëruar me mënjanimin e *konflikteve të interesit*, të *papajtueshmërive* dhe të *kufizimeve* të vendosura në ligje për punën e gjyqtarit. Të tria këto institucione janë kategori të ndara, por lidhen në mënyrë plotësuese me njëra-tjetrën. P.sh., parashikimi i rasteve

⁹ Kodi i Etikës gjyqësore, dt. 05.12.2000, miratuar nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare dhe Selim Kryeziu, “Etika e gjyqtarit, në “Revista Juridike”, nr.2, dhjetor 2005.

të papajtueshmërive me detyrën e gjyqtarit në Kodin e Procedurës Civile (neni 72), është garanci për respektimin e parimit të gjykatës së paanshme, pasi kështu mund të shmanget një konflikt interesi në gjykimin e një çështjeje.

Në këtë këndvështrim, ka autorë që e konsiderojnë paanshmërinë në sistemin gjyqësor, si vlerën e parë për garantimin e një gjyqësori të pakorruptuar dhe të pastër nga konfliktet e interesit¹⁰. Gjyqtari rumun Kristi Danilet sheh tri vlera kryesore që mbajnë në këmbë një sistem drejtësie të pakorruptuar: *paanshmërinë*, *pavarësinë* dhe *integritetin* e punonjësve të drejtësisë. Ndërsa, studiuesja shqiptare Arta Vorpsi, duke renditur treguesit e korrupsionit në gjyqësor, shënon konfliktin e interesit dhe paragjykimin e palëve, ndër treguesit më të qartë të një gjyqësori të korruptuar¹¹. Megjithatë duhet sqaruar se, jo çdo rast paanshmërie lidhet medoemos me korrupsionin. Ky i fundit nënkupton patjetër një veprim, kurse në rastet e analizuara më sipër, anshmëritë, papajtueshmëritë ose konfliktet e interesave janë vetëm potenciale. Kështu, vendimet e Gjykatës Kushtetuese të sipërpërmendura nuk testonin rastet e paanshmërisë në mënyrë thelbësore, por ato që potencialisht ose teorikisht, duhet të jenë të paanshme. Veprimet e gjyqtarëve që shkelin parimin e paanshmërisë ose krijojnë konfliktet e interesit, duhet t'i nënshtrohen procedimit penal. Sidoqoftë, edhe jurisprudenca e gjykatave të zakonshme dhe asaj Kushtetuese në lidhje me interpretimin dhe kuptimin e zbatimit të gjykatës së paanshme në kuadrin e procesit të rregullt, ka një rol të konsiderueshëm në parandalimin dhe luftimin e rasteve të korrupsionit ose të konfliktit të interesit në gjykata. Sidoqoftë, duhet theksuar se kjo jurisprudencë shtrihet kryesisht në gjykimin mbi “*dukjen e paanshmërisë*” ose perceptimin e saj, por jo në veprime konkrete të gjyqtarëve.

1.4. Perceptimi i parimit “gjykatë e paanshme”.

Për sa analizuam më sipër, duket qartë se Gjykata Kushtetuese i ka kushtuar vëmendje shikueshmërisë, ose asaj që mund të quhet ana formale e paanshmërisë, pasi edhe çështjet që ajo ka gjykuar nuk kanë pasur të bëjnë me elementë thelbësorë, apo me veprime që shkelin paanshmërinë, por me dukjen e tyre (*GJK., vendimi nr. 11/2013*). Në fakt, dukja e paanshmërisë

¹⁰Kristi Danilet, “Korrupsioni dhe antikorrupsioni në sistemin e Drejtësisë”, Konrad Adenauer 2009, (përkthyer në shqip dhe botuar në http://www.kas.de/ef/doc/kas_22459-1522-33-30.pdf?110526130640, vizituar për herë të fundit më 12.08.2013. Autori sheh tri vlera kryesore që mbajnë në këmbë një sistem drejtësie të pakorruptuar: Paanshmërinë, Pavarësinë dhe integritetin e punonjësve të drejtësisë. Fq.11-12

¹¹ Shih: Arta Vorpsi, “Korrupsioni në sistemin e drejtësisë dhe strategjitë antikorrupsion”, botuar në “Reforma Gjyqësore si një ndër 12 prioritetet e sfidës së integritetit të Shqipërisë në BE”, Tiranë, Korrik, 2012, fq. 122-123.

është gjithashtu, shumë e rëndësishme për mbarrëvajtjen e procesit gjyqësor dhe për legjitimimin e tij. Edhe më parë Gjykata Kushtetuese ishte shprehur se, *“respektimi i parimit të paanshmërisë mundëson krijimin e besimit tek gjyqësori me qëllim që drejtësia jo vetëm të bëhet, por dhe të shihet që po bëhet. Në demokraci, ligjshmëria e rolit të gjyqtarit varet jo vetëm nga qenia e tij, por dhe nga shfaqja e tij i paanshëm dhe i pavarur, duke qenë se roli i tij gjatë gjykimit duhet të jetë pasiv dhe super partes”* (GjK., vendimi nr. 23/2008). Gjykata Kushtetuese i ka kushtuar këtij vështrimi një rëndësi të madhe dhe ka pranuar se argumentet në vendimet e saj, kanë të bëjnë me paanësinë e dukshme. Madje, ish-gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese Sokol Sadushi, duke iu referuar dukjes së paanshmërisë, në veprën e tij *“Drejtësia Kushtetuese në Zhvillim”*, ka theksuar tekstualisht: *“Paanshmëria e vërtetë dhe të hequrit si i paanshëm janë të dyja themelore për ruajtjen e respektit ndaj drejtësisë”*¹². Në të njëjtin konkluzion arrijmë edhe duke lexuar vendimet e GJEDNJ-së, sidoqë rasti që po sjellim si shembull, shprehet më i rezervuar për rëndësinë që paraqet dukja e paanësisë së gjykatës: *“veç sjelljes personale të çdo anëtari të trupit gjykues, duhet të provohet nëse ka fakte bindëse të cilat vënë në dyshim paanshmërinë. Në këtë kuadër, edhe dukja e jashtme mund të ketë njëfarë rëndësie...”*¹³. Megjithatë, GJEDNJ-ja e ka evidentuar dukshëm këtë aspekt në Rezolutën e Këshillit të Evropës mbi Etikën Gjyqësore. Kjo e fundit, shpall 10 parimet kryesore të etikës gjyqësore, ndër të cilat paanshmëria zë vendin kryesor: *“Gjyqtarët duhet që të ushtrojnë funksionet e tyre në mënyrë të paanshme duke e garantuar dhe evidentuar paanshmërinë. Ata duhet të kujdesen që të shmangin në çdo rast konfliktin e interesit, por edhe përzierjen në të gjitha ato situata të cilat perceptohet se e përfshijnë apo krijojnë për gjyqtarët konflikt interesi”*¹⁴. Si përfundim, mund të themi se, kontributi që jep jurisprudenca e gjykatave, në përgjithësi, përqendrohet në thelbin që trajton *“teoria e paanësisë së dukshme”*, e cila sidoqoftë, është një aspekt shumë i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor.

2. Të dhëna dhe mësim nga monitorimi i rasteve në gjykatë mbi perceptimin e paanshmërisë.

¹² Sokol Sadushi, vep.cit. fq. 642

¹³ Shih: GJEDNJ, Driza kundër Shqipërisë, vep.cit., fq.116.


¹⁴ Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, e Këshillit të Evropës, Etika Gjyqësore, Art. II. Paanshmëria.

2.1. Shkaqet që ndikojnë në perceptimin e paanshmërisë së gjyqtarëve.

Në këtë pjesë të punimit do të përmbledhim disa gjetje dhe konkluzione që kanë dalë nga rezultatet e monitorimit të seancave gjyqësore, në gjykatën e shkallës së Parë, Tiranë, Shkodër, Elbasan, Vlorë në lidhje me respektimin e paanshmërisë nga gjyqtarët, perceptuar nga sjellja e këtyre të fundit, gjatë seancave gjyqësore. Parë rëndësinë që paraqet sjellja e paanshme e gjyqtarit për forcimin e pushtetit gjyqësor dhe rritjen e besimit të publikut ndaj tij, vëmendja jonë u përqendrua në monitorimin e sjelljes së jashtme të gjyqtarëve, gjatë seancave gjyqësore¹⁵.

Për të konkluduar në lidhje me sa më sipër, u shtruan 10 pyetje, të cilat synonin të nxirrnin në pah opinionin e monitoruesve nëse, krijonin veprimet e gjyqtarit perceptimin për njëanshmëri në proces, apo jo? P.sh., u shtrua pyetja përgjithësuese: *A ishte gjyqtari i paanshëm në vendime, deklarata, qëndrime dhe veprime?* Monitoruesit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë u përgjigjën *po*, në 76.19% të seancave të monitoruara, *jo*, në 5.71% të tyre. Ndërkohë, në 18% të seancave, monitoruesit nuk dhanë përgjigje, për shkak të shtyrjes së seancave, ose për shkak të mosperceptimit nga ana e tyre.

Grafiku. 1



Monitoruesit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër kanë konstatuar se nga 69 seanca të monitoruara, në 66 prej tyre gjyqtari ka qenë i paanshëm në *vendime, deklarata, qëndrime dhe veprime*. Nuk është konstatuar një fakt i tillë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe Vlorë.

¹⁵ Monitorimi është kryer nga studentë të fakultetit të Drejtësisë, të trajnuar dhe të drejtuar nga avokatë. Perceptimi i tyre është i pasqyruar përmes plotësimit të pyetësorëve.

Monitoruesit që i kanë perceptuar vendimet, deklaratat, qëndrimet dhe veprimet e gjyqtarëve si të paanshme, komentojnë sjelljen korrekte të gjyqtarëve gjatë gjithë seancës gjyqësore në adresë të palëve në proces. Ata karakterizojnë sjelljen e gjyqtarëve si vijon¹⁶:

1. Gjyqtarja/i u shpjegoi të drejtat të dyja palëve në proces.
2. Gjyqtarja/i u tregua e vëmendshme në mënyrë të barabartë si ndaj palës paditëse edhe ndaj palës së paditur
3. Gjyqtarja/i nuk favorizoi ndonjë palë në raport me palën tjetër.
4. Gjyqtarja/i afroi kushte të barabarta për të gjitha palët.
5. Gjyqtarja/i ishte e drejtë dhe objektive në lidhje me të dyja palët.
6. Gjyqtarja/i nuk përdori ton fyes në seancë ndaj asnjërës palë.
7. Gjyqtarja/i i trajtoi avokatët përfaqësues të palëve me respekt dhe komunikoi me ta me gjuhë profesionale.
8. Gjyqtarja/i ofroi barazi për çdo palë në parashtrimin e çështjes së saj.

Duke analizuar komentet e monitoruesve, në 6 seanca gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe 3 seanca gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër krijojmë një perceptim më të mirë mbi dukjen e paanshmërisë së gjyqtarit në seancë dhe kuptojmë më mirë se çfarë do të thotë të sillesh në mënyrë të paanshme. Komentet u adresohen më shumë deklaratave dhe qëndrimeve të gjyqtarëve dhe më pak, vendimeve dhe veprimeve të tyre. Përshtypjet dhe komentet e monitoruesve janë dhënë rast pas rasti, për çdo seancë gjyqësore të monitoruar, gjë që e vështirëson nxjerrjen e konkluzioneve përgjithësuese. Megjithatë, duke bërë një përgjithësim të problematikave të komentuara më shpesh nga monitoruesit, mund të grupojmë disa perceptime.

1. Monitoruesit kanë perceptuar veprime e qëndrime të njëanshme të gjyqtarëve në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë duke komentuar si më poshtë¹⁷:
 - Gjyqtarja ishte e ashpër në komunikim me avokatin e njëjës palë;
 - Gjyqtarja e ofendoi avokatin e palës paditëse;

¹⁶ Këto komente janë evidentuar nga skedat e monitorimit të sipërcituar. Ato ndodhen pranë bibliotekës së Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare, Rruga Vaso Pasha, Tiranë.

¹⁷ Nga monitorimi i seancave me objekt konflikte pune, diskriminim dhe barazi gjinore (*gjithsej 20 seanca të monitoruara*).

- Gjyqtari e trajtoi shumë keq palën e paditur, e ofendoi atë;
- Gjatë dhënies së pretendimeve nga pala paditëse, gjyqtarja bisedonte me sekretaren dhe bënte punë të tjera;
- Gjyqtari iu drejtua palës së paditur gjatë pretendimeve të tij, me këto fjalë: “Nesër do të jesh ti në vendin e kësaj zonjës që është hequr nga puna. Nuk duhet të flasësh kështu”;

Sikurse vihet re, monitoruesit kanë krijuar perceptim të qëndrimeve të njëanshme nga ana e gjyqtarit, për shkak të ***gjuhës së ashpër ndaj njëres prej palëve ndërgjyqëse***. Përdorimi i kësaj gjuhe nuk na shpie medoemos në veprime dhe vendime të njëanshme nga ana e gjyqtarit. Megjithatë, gjyqtarët duhet të jenë të kujdesshëm në qëndrimin dhe fjalët që thonë gjatë procesit, pasi krijojnë përshtypje të njëanshmërisë.

Mosvëmendja e gjyqtarit kur pala parashtrohet ose u përgjigjet pyetjeve, mund të krijojë përshtypjen e qëndrimeve të njëanshme, prandaj gjyqtari duhet të jetë vazhdimisht i vëmendshëm në seancë. Një koment i tillë është bërë edhe gjatë monitorimit të seancave në çështje të tjera civile, nga të cilat bie në sy koment i monitoruesit gjatë një seance: “*Gjyqtarja nuk i kushtoi rëndësi prezencës së palëve. Mungoi formaliteti në çeljen dhe mbylljen e seancës*”. Më i dukshëm bëhet ky perceptim në seancat gjyqësore për lëshimin e urdhrave të mbrojtjes dhe urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes¹⁸, në të cilin na tërheqin vëmendjen dy komente të kryera nga monitoruesit, të cilat po i përmbledhim në vijim:

- “Në shumë momente pala paditëse kishte nevojë të jepte shpjegime, por gjyqtarja megjithëse i dëgjoi, nuk u kushtoi rëndësinë e duhur”;
- “Gjyqtarja nuk i kushtoi vëmendje avokatit dhe palës paditëse”;
- Gjyqtarja iu drejtua paditëses me një ton shumë të ashpër duke e detyruar t’u përgjigjej me saktësi pyetjeve që ajo bënte;

Nga të gjitha grupçështjet që u monitoruan, ka pasur më tepër komente në 32 seancat gjyqësore të urdhrave të mbrojtjes dhe urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes. Me këto komente

¹⁸ U monitoruan gjithsej, 31 seanca gjyqësore të proceseve për lëshimin e urdhrave të mbrojtjes dhe urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes.

monitoruesit dëshmojnë se ka më shumë arsye të perceptojnë sjellje të anshme nga ana e gjyqtarëve. Në vijim po sjellim disa prej komenteve të paraqitura nga monitoruesit për këtë grupçështjesh:

- Shprehje e gjyqtarës: “Si ta ka bërë policia ty kërkesën, ti nuk ke prova. Pse duhet të besoj ty dhe jo të paditurin?”
- Shprehje e gjyqtarës: “Pse duhet të besoj që je e dhunuar?”
- “Gjykata nuk i kushtoi rëndësi pyetjeve të palës paditëse, nuk i shpjegoi asgjë në lidhje me provat që i kërkonte palës paditëse, por komunikonte me sekretaren për vazhdimin e seancës gjyqësore”;
- “Gjyqtarja nuk e lejoi paditësen të paraqiste pretendimet dhe të mbrohej me avokat”;
- “Jo, nuk ofroi barazi, pyeste vetëm palën paditëse, nuk e lejoi palën e paditur të fliste”;
- “Aspak profesionale, dukej sikur gjyqtarja i kërkonte llogari palës paditëse pse e kishte bërë padinë”;
- “Gjyqtarja nuk e lejoi paditësen të ngrinte pretendimet e saj”.

Mendojmë se ky qëndrim i gjyqtarëve mund të lidhet edhe me disa **paragjykime që u adresohen dhunës dhe personave të dhunuar**. Gjithashtu, ka **disa veçori procedurale** që paraqiten në ligjin “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të cilat **sjellin procedura më lehtësuese për paditësin**, në raport me ato të përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile. Prandaj, paragjykimi që tregojnë në disa raste gjyqtarët, sidomos kur nuk ka shenja të dhunës fizike, lidhet edhe me skepticizmin e tyre për zbatimin e këtij ligji. Ndoshta kjo shpjegon arsyen që në disa raste, gjyqtaret/ët shpërthejnë dhe kryejnë veprime në dukje të njëanshme. Këto qëndrime të gjyqtarëve mund të na shpien edhe në vendime të njëanshme.

Në disa raste, gjyqtarët kërkojnë të mbyllin sa më shpejt seancat gjyqësore dhe nuk i lejojnë palët të parashetrojnë pretendimet dhe pyetjet e tyre. Kjo lidhet edhe me ngarkesën e gjyqtarëve, prandaj të gjithë gjyqtarët kërkojnë të shpejtojnë. Por, **mosakordimi i një kohe të mjaftueshme për palët, për të dhënë shpjegime në seancë**, mund të konceptohet si qëndrim i njëanshëm i

mbajtur nga gjykata. Prandaj është e nevojshme që koha të menaxhohet në mënyrë të barabartë për të dyja palët, pavarësisht se sa e shfrytëzojnë ata, ose se sa kanë nevojë ata.

Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, problemet që janë evidentuar nga monitorimi i seancave gjyqësore me objekt zgjidhje martese, (*gjithsej 29 seanca të monitoruara*), lidhen në mënyrë të veçantë me çështjen e krijimit të besueshmërisë ndaj ***vendimit për caktimin e psikologut, ose të punonjësit social***. Nga 29 seanca gjyqësore të monitoruara, në 12 prej tyre, procesi ishte në fazën e caktimit të psikologut. Ky moment është një nga fazat më të rëndësishme për procesin dhe për palët, pasi është fjala për përmbushjen e kërkesave të tyre në marrjen e përgjegjësisë për rritjen dhe edukimin e fëmijëve të mitur. Prandaj, transparenca dhe paanshmëria që duhet të dëshmojë gjyqtari në këtë fazë janë të nevojshme për perceptimin e sjelljes së tij si një sjellje e paanshme. Por, ajo çka vihet re nga monitorimi është se të gjitha perceptimet për veprime dhe vendime të anshme të gjyqtarit lidhen pikërisht, me këtë fazë. Monitoruesit kanë konstatuar se gjyqtarët, në caktimin e ekspertit mbajnë parasysh vetëm kërkesat e nenit 155 të Kodit të Familjes. Në bazë të tij, *“përpara se gjykata të marrë një vendim të përkohshëm ose përfundimtar, lidhur me mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, të drejtës së vizitës ose të besuarit të fëmijës njërit ish-bashkëshort, duhet të thërrasë një psikolog ose punonjës social...”*, i cili duhet të japë mendimin. Monitoruesit konstatojnë se gjykata e zbaton këtë detyrim të parashikuar nga Kodi i Familjes në çdo rast. Madje, ata kanë konstatuar se gjykata e thërret ekspertin edhe në rastet kur martesa është zgjidhur me pëlqimin e të dy bashkëshortëve, me qëllim verifikimin nëse marrëveshja siguron në mënyrë të mjaftueshme apo jo, interesat e fëmijëve, ose të bashkëshortëve.

Sjellja që monitoruesit e konsiderojnë jo në përputhje me parimin gjykatë e paanshme, është ***moszbatimi në të gjitha rastet i neneve 225, 226, 227 të Kodit të procedurës civile***, të cilat vendosin procedurat për caktimin dhe pyetjen e ekspertit. Kështu p.sh., në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë nga komenti i një monitoruesi në seancën gjyqësore, lexojmë tekstualisht: *“Vendimi për thirrjen e psikologes jo transparent. Gjykata nuk zbatoi asnjë procedurë në lidhje me psikologun, palët nuk mësuan emrin, mbiemrin apo nëse psikologja ishte e pajisur me diplomë. Gjykata nuk i pyeti palët nëse ishin dakord me psikologun. Gjykata nuk i caktoi detyra psikologes, madje psikologja nuk bëri betimin para gjykatës”*¹⁹.

¹⁹ Referuar në seancën e monitoruar të çështjes “Zgjidhje martese”, dt.16.10.2012 Ora 13.30.

Problematika të ngjashme janë konstatuar nga monitoruesit në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Shkodër, Elbasan dhe Vlorë.

Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, në 15% të 18 seancave të monitoruara, me objekt zgjidhje martese ka rezultuar se psikologët janë përzgjedhur në mënyrë selektive nga gjyqtarët. Edhe në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan është evidentuar nga monitorimi se përzgjedhja e psikologut bëhet në mënyrë selektive dhe jo transparente nga gjyqtari i çështjes.

Pra, duke mënjeluar zbatimin e Kodit të Procedurës Civile, nuk zbatohen detyrimet ligjore për caktimin psikologut dhe mënjanohet pjesëmarrja e palëve në caktimin e psikologut, pra hiqet mundësia e tyre për t'u shprehur në këtë fazë të procesit.

Një sërë problemesh të tjera linden **për shkak të mungesës së strukturës dhe rrjetit të psikologëve**. Gjykata nuk ka një listë të miratuar të psikologëve dhe të punonjësve socialë, të cilët të jenë jo vetëm të diplomuar, por edhe të mirëtrajnuar, si dhe të aftë për të kryer detyrën. Nuk ka akte apo protokolle me kriteret dhe procedurat që duhet të plotësojnë psikologët dhe punonjësit socialë me qëllim që të përzgjidhen nga gjykata, prandaj përzgjedhja e ekspertit i lihet rastësisë ose njohjeve personale. Madje, në një çështje tjetër me objekt civil, monitoruesi shënon se, *“gjyqtarja iu drejtua palëve nëse kishin ndonjë emër eksperti, pasi ai nuk njihte ndonjë ekspert në këtë fushë”*. Natyrisht, në këto kushte, kjo mund të ndodhë, por është e udhës që gjykatat të ketë listat e përgatitura dhe bazën e të dhënave përkatëse.

Edhe **kërkesat për të pasur një psikolog ose punonjës social falas**, kanë përfunduar në disa raste në paragjykime për anshmëri. Kështu p.sh., në njërën prej seancave gjyqësore të monitoruara, gjykata nuk e pranoi kërkesën e paditëses për të thirrur një psikolog nga OJF-të që japin shërbimin ligjor falas, pasi pala kundërshtare e konsideroi këtë një favorizim për paditësen dhe ngriti pretendimin se shërbimi falas në këtë rast, mund të kishte cilësi më të ulët në ekspertizë, sesa ai që paguhet në treg të lirë²⁰.

Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, një listë me katër emra psikologësh, dy prej të cilëve janë të pajisur me nr. Nipti ka qëndruar e afishuar në ambientet e kësaj gjykate gjatë periudhës së monitorimit.

²⁰ Shih: Skedën e monitorimit të seancës gjyqësore me objekt zgjidhje martese, dt.12.3.2013 ora 12.00

Përveç tyre, pranë kësaj gjykate punojnë edhe një numër psikologësh, të cilët nuk janë të rregjistruar për ushtrimin e profesionit dhe pagesa e tyre nuk mbështetet në ndonjë rregullore apo kontratë të palëve.


Në kushtet kur nuk ka asnjë strukturë të psikologëve të trajnuar që të njihet dhe të veprojë në gjykatë, vendimi i gjyqtarës për të mos e pranuar kërkesën e paditëses nuk na duket i qortueshëm, por nga ana tjetër, ky vendim nuk merr parasysh paaftësinë paguese të grave në prag të divorcit. Prandaj është e nevojshme që legjislacioni të plotësohet për të rregulluar këto raste. Udhëzimi ekzistues i Këshillit të Ministrave Nr. 4, datë 12.12.2012, *Për caktimin e masës së shpenzimeve dhe pagesave të ekspertëve dhe dëshmitarëve gjatë procesit gjyqësor*, ka nevojë për plotësime lidhur me këtë ekspertizë.

Shtyrja e seancave gjyqësore, në një kohë të paarsyeshme për shkak se njëra nga palët nuk ka kryer pagesën e ekspertit, mund të lërë gjithashtu, shkas për perceptimin e njëanshmërisë.

Kështu, psh., në një kërkesë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*shih: GJK, vendimi nr. 16/2013*), kërkuuesi ka pretenduar se, gjykata nuk është treguar e paanshme, pasi ka pranuar të gjitha kërkesat e subjektit të interesuar, madje, duke shtyrë edhe tre herë shpalljen e vendimit për t'i dhënë mundësi subjektit të interesuar që të paguante diferencën e taksës gjyqësore. Sidoqoftë, në këtë rast, Gjykata Kushtetuese nuk e ka konsideruar këtë sjellje si shkelje të parimit të paanësisë.

2.2. *Sjellja ndaj avokatit si faktor që ndikon në perceptimin e paanshmërisë së gjyqtarëve.*

Edhe sjellja e gjykatës ndaj avokatëve përfaqësues të palëve, krijon perceptime të ndryshme, shpesh edhe për njëanshmëri. Kjo vihet re nga komentet mbi qëndrimin e gjykatës ndaj avokatit. Kështu p.sh., pyetjes: *A i trajtoi Gjyqtari avokatët me respekt dhe si profesionistë?* Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë në 69.52% të rasteve të monitoruara u përgjigjën po dhe vetëm në 5.71% e tyre u përgjigjën jo. Në 26 seanca, ose 24.76% të tyre, monitoruesit nuk dhanë një përgjigje (shkaku mbetet kryesisht, shtyrja e seancave gjyqësore ose mosperceptimi nga monitoruesi).

Grafiku 2.

Sidoqoftë, nëse u drejtohem komenteve të monitoruesve që u përgjigjën jo, gjejmë këto perceptime:

- Gjyqtarja/i nuk e lejoi avokatin të fliste;
- Nuk e pranoi, i kërkoi autorizim nga Qendra ku ishte i punësuar si avokat;
- Gjyqtarja nuk i kushtoi vëmendje avokatit dhe palës paditëse;
- Jo, nuk e lejoi avokatin të fliste;
- Gjyqtarja ishte pak e ashpër në komunikim me avokatin;
- Gjyqtarja e ofendoj avokaten e palës paditëse;
- Kur po parashtronte pala tjetër, Gjyqtarja iu drejtua avokates me fjalët “hapi veshët”.

Teorikisht, këto komente mund të lënë shkas që të perceptosh se në disa raste, sjellja e gjykatës nuk është në përputhje me parimin e paanshmërisë së saj, në dukjen e tij. Sikurse e theksuam, toni i ashpër ose fyes ndaj palëve, mosvëmendja dhe fjalët fyese ndaj tyre, si dhe toni ashpër ndaj avokatëve, krijojnë dyshime që ulin besueshmërinë ndaj paanshmërisë së gjykatës. Kjo edhe për faktin se krijojnë një frenim të pjesëmarrjes së palëve në gjykim dhe nuk i lejojnë ato të shprehën lirisht. Gjithashtu, ato e cenojnë pozicionin që duhet të mbajë gjyqtari si *super partes*.

Natyrisht, këtu nuk përfshihen rastet kur Gjykata është rigoroze për zbatimin e kërkesave formale të ligjit. Kështu, nuk mund të konsiderohet sjellje jo e përshtatshme qëndrimi i gjyqtarit/es, sipas komenteve që vijojnë:

- Nuk e pranoi avokatin sepse nuk kishte kartonin e vitit 2013, edhe pse kishte atë të mëparshmin.
- Gjyqtarja e përdori gjuhën teknike vetëm me avokaten e palës, duke iu drejtuar palës paditëse që ishte e moshuar, me shpjegime më të thjeshta.

Nga gjithë sa trajtuam më sipër, lind pyetja: A mund të përdoren këto perceptime si shkaqe të arsyeshme për të ankimuar vendimin gjyqësor në një gjykatë më të lartë? Cila do të ishte ndjeshmëria e avokatit ndaj këtyre perceptimeve të nxjerra nga monitorimi? Disa prej tyre mund të mbeten vetëm në kuadrin e etikës së gjyqtarit, por disa të tjera mendojmë se janë të një shkalle të tillë që e dëmtojnë procesin gjyqësor, fjala vjen mosdhënia e mundësisë për të parashtruar kërkesat përpara gjykatës, ose cenimi i kohës së njërës palë në raport me palën tjetër, ose moszbatimi i neneve përkatëse të Kodit të Procedurës Civile, në procedurat për caktimin e ekspertit etj., mund të parashtrohen nga avokatët si shkaqe që shkelin parimin e paanësisë dhe cenojnë të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Sidoqoftë, këto kërkesa duhet të bazohen edhe në prova, si fjala vjen, në procesverbalin e seancës gjyqësore. Në këtë aspekt, vendosja e sistemit elektronik dëgjimor të regjistrimit do të krijojë mundësi për një proces më të mirë e më të besueshëm.

3. Perceptimi i paanshmërisë në gjykim nga vetë gjyqtarët. Administrimi i institutit të heqjes dorë të gjyqtarit nga gjykimi i çështjes konkrete, me qëllim moscenimin e thelbit të drejtësisë.

E shohim të udhës që analizën e mësipërme ta plotësojmë edhe nga këndvështrimi i perceptimit të vetë gjyqtarëve për respektimin e parimit “*gjykatë e paanshme*”. Në këtë analizë të shkurtër, jemi adresuar sidomos në grupçështjet me objekt urdhra të mbrojtjes dhe disa konflikte të tjera në marrëdhëniet familjare të lidhura me to, pasi ato kanë afate mjaft të shkurtra gjykimi dhe rrezikojnë më shumë të cenohen nga përdorimi i institutit të heqjes dorë të gjyqtarit. Ne monitoruam kërkesat dhe vendimet e gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për

heqjen dorë në periudhën Janar-Qershor 2013 dhe konstatuam gjithsej, 7 kërkesa e vendime për heqjen dorë nga gjykimi i urdhrave të mbrojtjes UM dhe urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes UMM, si dhe 6 kërkesa e vendime për heqjen dorë nga gjykimi i konflikteve të tjera familjare. Shkaqet e renditura për paraqitjen e kërkesave janë të natyrës objektive e subjektive dhe mund të grupohen si më poshtë:

1. Heqje dorë nga gjykimi i UM dhe UMM, për shkak se kanë gjykuar ato edhe më parë, me të njëjtin subjekt dhe me të njëjtën palë.
2. Heqje dorë nga gjykimi i UM dhe UMM, për shkak se më parë kishin zgjidhur martesën me të njëjtët palë.
3. Heqje dorë nga gjykimi i çështjes për shkak të miqësisë familjare me njërën nga palët.
4. Heqje dorë nga gjykimi i çështjes për shkak të pozicionit të bashkëshortit si avokat i njëjës prej palëve, në një gjykim tjetër.
5. Heqje dorë nga gjykimi i çështjes për shkak se ka mbiemër të njëjtë me njërën nga palët.
6. Heqje dorë nga gjykimi i çështjes për shkak se njëra nga palët është shprehur se gjyqtari nuk është i paanshëm.
7. Heqje dorë nga gjykimi i çështjes për shkak se gjyqtari ka shprehur më parë mendim për këtë çështje në disa rrethana të rastësishme.

Aspekti i parë që evidentohet në këtë rast është se, gjyqtarët janë të përgjegjshëm për rëndësinë e këtij parimi dhe zbatojnë kërkesat e nenit 72 të Kodit të Procedurës Civile. Por nga ana tjetër, një tejkalim i paarsyeshëm i përdorimit të dorëheqjeve, mund të ndikonte në gjykimin me afate të paarsyeshme, ose të cenonte gjykimin e çështjes, ose ta shndërronte institutin e heqjes dorë si mjet abuziv në duart e palëve a të avokatëve, për të shtyrë gjykimin ose për të arritur qëllime pragmatiste, duke e shfrytëzuar proceduralisht. Këto shqetësime marrin kuptim të veçantë tek gjykimi i urdhrave të mbrojtjes, pasi dorëheqja dëmton mjaft respektimin e afateve që ligji ka parashikuar për gjykimet e tyre. Këto gjykime kanë karakteristika të veçanta dhe janë emergjente, gjithashtu, vendimet që japin gjykatat janë të përkohshme. Prandaj regjimi i dorëheqjes prej tyre, për mendimin tonë, duhet të interpretohet më tepër mbi bazën e testit të arsyes së gjerë, se sa në kuptimin e ngushtë. Kështu, p.sh., nuk mendojmë se është e nevojshme të hiqet dorë nga gjykimi i urdhrit të mbrojtjes, për shkak se gjyqtari ka gjykuar më parë zgjidhjen e martesës midis këtyre palëve. Për më tepër, zgjidhja e martesës kërkohet të bëhet pa

u shprehur për fajësinë e bashkëshortëve. Gjithashtu, mbiemri i njëjtë në mënyrë rastësore nuk mund të shërbejë si shkak për heqjen dorë të gjyqtarit. Kjo, nuk krijon një pozicion të anshmërisë objektive, pasi mbiemri i njëjtë nuk e krijon si i tillë një lidhje apo konflikt interesi midis gjyqtarit dhe palës.

Probleme vërejmë edhe në lidhje me shkaqet subjektive për dorëheqjen e gjyqtarit. P.sh., në dy nga vendimet e monitoruara, gjyqtari ka hequr dorë, pasi pala i ka akuzuar ata si gjyqtarë që nuk janë të paanshëm për gjykimin e çështjes. Por, në një rast të gjykimit të urdhrit të mbrojtjes, paditësi nuk ka paraqitur asnjë argument se përse gjyqtari nuk është i paanshëm, megjithatë ka kërkuar përjashtimin e tij, thjesht se ai ashtu mendon (*shih: Gjykata e Shkallës I-rë, Tiranë vendim nr. 10853 akti, dt. 12.03.2012*). Gjyqtarja ka pranuar kërkesën e paditësit 15 ditë më pas nga data e regjistrimit të kërkesës, që do të thotë një dështim i gjykatës në lëshimin e urdhrit të mbrojtjes, që duhet të ishte kryer brenda 15 ditëve.

Ka raste kur ankesa e palës për anshmëri subjektive është krejt e pabazuar dhe fyese për gjykatën. P.sh., në një rast me objekt zgjidhje martese, pala paditëse u shpreh gjatë gjykimit në adresë të gjyqtarës se, *“nuk mund të gjykojë këtë çështje pasi nuk është nënë vetë dhe ka marrë para nga pala e paditur përderisa gjykimi vazhdon kaq gjatë”*. (*seanca gjyqësore dt. 02.04.2013, me objekt “Zgjidhje martese”*). Gjyqtarja ka hequr dorë nga gjykimi pasi është ndier personalisht e fyer dhe nuk e ka ndjerë veten se nga ai moment mund të gjykojë si e paanshme. Natyrisht, shprehje të tilla burojnë nga personaliteti që ka pala, por mund të burojnë edhe nga mosbesimi që ajo ka ndaj gjykatës në përgjithësi, prandaj gjyqtarët duhet të jenë shumë të kujdesshëm në menaxhimin e situatave të tilla.

Për sa më sipër, mësimi që duhet të marrim është se administrimi i të drejtës së gjyqtarit për të hequr dorë, duhet të bëhet vetëm në raste të përligjura objektivisht, si raste që komprometojnë paanshmërinë e gjykatës. Kurse, në rastet e paragjytimeve subjektive, gjyqtarët duhet të jenë shumë të kujdesshëm në heqjen dorë, me qëllim që të mos dëmtohet mbarëvajtja e punëve në gjyqësor, ekonomia gjyqësore, shkelja e afateve, si dhe të mos lejohen precedentë të përdorimit të dorëheqjes së gjyqtarit si mjet abuziv për shtyrjen e pambarimtë të procesit gjyqësor.

4. Përmbledhje e konkluzioneve dhe sugjerimeve.

1. Nga analiza e Jurisprudencës së gjykatave kombëtare e ndërkombëtare mësojmë se, respektimi i parimit “gjykatë e paanshme”, ndikon efektivisht për forcimin e pushtetit gjyqësor, rritjen e besueshmërisë së publikut ndaj tij, respektimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor, si dhe për parandalimin e korrupsionit në dhënien e drejtësisë.
2. Vërejmë një rritje të kërkesave të palëve për të kundërshtuar vendimet e gjykatave për shkak të mosrespektimit të parimit “gjykatë e paanshme”. Prandaj, është e nevojshme që ato të ndihmojnë në mësimet për të ardhmen, por edhe duhet të administrohen kujdesshëm me qëllim ndalimin e abuzimeve.
3. Ka nevojë të mbahet parasysh, se Gjykatat jo vetëm duhet të garantojnë zbatimin e parimit të paanshmërisë, por edhe duhet ta evidentojnë atë. Prandaj, sjellja e dukshme personale e çdo anëtari të trupit gjykues duhet të jetë në përputhje me parimin “gjykatë e paanshme”.
4. Dukja e jashtme e sjelljes së paanshme ka rëndësi për mbarëvajtjen e procesit gjyqësor, si dhe për forcimin e besimit të publikut ndaj gjyqësorit.
 - Disa nga shkaqet për perceptimin e sjelljes së anshme të gjyqtarit në seancë mund të jenë:
 - Tonit i ashpër dhe fyes i gjyqtarit ndaj njëres palë dhe/ose avokatit të saj;
 - Ofendimet ndaj njëres prej palëve;
 - Mosvëmendja së gjyqtarit ndaj shpjegimeve të njëres palë dhe/ose avokatit të saj;
 - Shtyrja së seancave gjyqësore për t’i dhënë mundësi njëres palë;
 - Deklarimet mosbesuese ndaj njëres palë, të shprehura në seancë;
 - Mosakordimi i kohës së barabartë për të paraqitur parashtrimet të dyja palët;
 - Ndjekja së procedurave jo në mënyrë formale dhe transparente për marrjen e vendimeve të ndërmjetme të gjykatës;
5. Shkaqe të jashtme që mund të krijojnë perceptime për një gjykatë jo të paanshme mund të jenë:
 - Mungesa së strukturave që vijnë në ndihmë të procesit gjyqësor me ekspertizë, gjë që nuk i mundëson gjyqtarit të marrë vendime tërësisht transparente.
 - Mungesa e shërbimit ligjor falas në rastet kur pala nuk ka mundësi .
 - Mungesa e rregullave dhe e protokolleve të sjelljes së paanshme në situata të caktuara.

Për sa më sipër sugjerojmë:

1. Të përmirësohen standardet dhe kërkesat për gjyqtarët, me qëllim sjelljen e paanshme jo vetëm thelbësisht, por edhe në dukje të gjyqtarit, gjatë procesit gjyqësor. Sugjerojmë të rishikohet Sistemi i vlerësimit profesional dhe etik të gjyqtarëve, duke mbajtur parasysh jurisprudencën më të re në këtë fushë. Kjo detyrë duhet të kryhet nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë.
2. Krijimi dhe institucionalizimi i rrjetit të psikologëve dhe punonjësve socialë që do të ndihmojnë me ekspertizë procesin gjyqësor. Kjo detyrë duhet të kryhet nga Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Gjykatat, Ministrinë që ndjek çështjet sociale dhe organizatat e shoqërisë civile.
3. Vendosja e tarifave për shërbimin e psikologut dhe të punonjësit social në proceset e zgjidhjes së martesave. Të parashikohen rastet kur ky shërbim duhet të jepet falas. Kjo detyrë duhet të kryhet nga Ministria e Drejtësisë dhe Këshilli i Ministrave. Udhëzimi ekzistues i Këshillit të Ministrave Nr. 4, datë 12.12.2012, për caktimin e masës së shpenzimeve dhe pagesave të ekspertëve dhe dëshmitarëve gjatë procesit gjyqësor, ka nevojë për plotësime lidhur me këtë ekspertizë. Ose mund të ketë një udhëzim të ri vetëm me këtë objekt.
4. Vendosja e kërkesave dhe standardeve për psikologët dhe punonjësit socialë që do të japin ekspertizë në gjykatë. Trajnimi i tyre. Kjo, është detyrë e ministrisë së Drejtësisë, në bashkëpunim me ministrinë e çështjeve sociale.
5. Krijimi dhe institucionalizimi i rrjetit të avokatëve që do të ndihmojnë me ndihmë ligjore falas, viktimat e dhunës në familje në proceset gjyqësore për lëshimin e urdhrave të mbrojtjes. Kjo detyrë duhet të kryhet nga Komisioni Shtetëror i Ndihmës juridike dhe Dhoma Kombëtare e Avokatisë, në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë.
6. Të përmirësohen trajnimet dhe shkëmbimet e përvojave me qëllim një dukje dinjitoze e gjykatës së paanshme. Kjo detyrë kryhet nga Shkolla e Magjistraturës.
7. Të përmirësohen standardet dhe kërkesat për avokatët, me qëllim që të njohin mirë sjelljen e avokatit në proceset gjyqësore dhe atë të gjyqtarit, në kuadrin e parimit gjykatë e paanshme. Kjo detyrë kryhet nga e Dhoma Kombëtare e Avokatisë.
8. Të shtohen dhe të përmirësohen studimet në këtë fushë, për të gjykuar më mirë mbi parametrat e institutit të heqjes dorë të gjyqtarit në rastet kur ka dyshime për anshmëri.

Kjo bëhet me qëllim që të mos cenohen afatet e gjykimit dhe thelbi i vetë procesit gjyqësor. Kjo detyrë kryhet nga gjykatat, Shkolla e magistraturës, Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

9. Të shtohen dhe të përmirësohen studimet në këtë fushë, me qëllim kuptimin më të mirë të këtij parimi në të gjithë dimensionin dhe ndërveprimin e tij me kuptimin e një gjykate të pavarur dhe të pakorruptuar. Detyrë e institucioneve të arsimit juridik.

III. E DREJTA PËR TË KËRKUAR DREJTËSI (AKSESI) NË GJYKATË.

1. Standardet ligjore e jurisprudenciale të vendosura në nivel ndërkombëtar e kombëtar.

E drejta për të kërkuar drejtësi, ose aksesin në gjykatë, është element thelbësor për respektimin e të drejtave dhe lirive themelore dhe në veçanti, të procesit të rregullt ligjor. E lidhur ngushtë edhe me efektivitetin e procesit gjyqësor, respektimi i kësaj të drejte ndikon drejtpërdrejt në fuqizimin e pushtetit gjyqësor. Gjithashtu, aksesin në gjykatë është i domosdoshëm për të siguruar zbatimin dhe sundimin e ligjit.

Ishte kjo arsyeja që ne vendosëm të monitoronim disa aspekte të kësaj të drejte, në grupçeshtjet objekt monitorimi. Kjo e drejtë përfshin disa elementë thelbësorë, të cilat janë sanksionuar në disa akte ndërkombëtare, në Kushtetutën e RSh dhe në ligjet kombëtare. Nga ana tjetër, jurisprudenca gjyqësore ka shërbyer për të konkretizuar dhe për të kuptuar më mirë këtë të drejtë. Prandaj, edhe jurisprudenca e GJEDNJ-së dhe ajo e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë kanë qenë objekt studimi me qëllim hartimin e skedës monitoruese në punimin që po paraqesim²¹.

Duke ndjekur me vëmendje standardet ndërkombëtare mbi aksesin në drejtësi dhe analizën që GJEDNJ dhe GJK i kanë bërë kësaj të drejte, arrijmë në konkluzionin se, *e drejta për të kërkuar drejtësi (akses në gjykatë)* është një e drejtë komplekse dhe *e drejta për t'iu drejtuar gjykatës* nuk është gjë tjetër veçse një pjesë përbërëse e saj. E drejta për akses në drejtësi lidhet edhe me disa të drejta të tjera, disa prej të cilave nuk janë sanksionuar shprehimisht në aktet ligjore ndërkombëtare, porse janë përpunuar nga jurisprudenca ndërkombëtare. Gjithashtu, disa elementë të kësaj të drejte janë evidentuar nga legjislacionet kombëtare, veçanërisht legjislacionet procedurale administrative, civile e penale. P.sh., e drejta për të pasur një gjykim të drejtë dhe të hapur është sanksionuar në KEDNJ, (neni 6/1), si dhe në Kartën e të Drejtave Themelore të BE-së (neni 47/2). E drejta për t'u dëgjuar nga gjykata është një e drejtë kushtetuese dhe është sanksionuar shprehimisht nga Kushtetuta e RSh (neni 33/1). Kurse, e

²¹ Për standardet ndërkombëtare të së drejtës për akses në drejtësi dhe për jurisprudencën ndërkombëtare shih: “Drejtësisë. Analizë e procesit civil në gjykatat e rretheve gjyqësore”, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, prezencë në Shqipëri, 2012, fq. 99-102; Për kuadrin ligjor shqiptar shih: po aty, 102-106; Për Jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese të RSh, shih: Sokol Sadushi, “Drejtësia...”, vep.cit., fq. 626-638

drejta për t'iu drejtuar gjykatës, nuk është sanksionuar shprehimisht nga ndonjë akt ligjor, por është përpunuar nga jurisprudenca e GJEDNJ, në disa nga vendimet të saj²².

Në analizë të tyre, ne mund të evidentojmë disa elementë të së drejtës për akses, të cilat po i rendisim si vijon:

- E drejta për t'iu drejtuar Gjykatës
- E drejta për të pasur një gjykim të drejtë dhe të hapur
- E drejta për të marrë pjesë në gjykim
- E drejta për t'u dëgjuar nga gjykata
- E drejta për të kontaktuar gjykatën dhe avokatin
- E drejta për t'u informuar dhe për të marrë njoftim për të gjitha procedurat
- E drejta për t'u konsultuar dhe për të patur të gjitha lehtësitë për t'u përgatitur për gjykim
- E drejta për të pasur një vendim përfundimtar nga gjykata
- E drejta për të ekzekutuar vendimin e formës së prerë të Gjykatës.

2. Gjetjet nga procesi i monitorimit.

Objekt monitorimi nuk janë të gjitha aspektet që sikurse përshkruam më sipër, mendojmë se përfshihen në aksesin e palëve në gjykatë. Ne jemi përqendruar vetëm në dy aspekte të pengesave për akses: në pamundësinë objektive të palëve për të paguar shpenzimet gjyqësore dhe pamundësinë e tyre për të kontaktuar lirisht me gjykatën dhe trupin gjykues, si dhe për t'u njoftuar dhe informuar nga gjykata.

2.1. Tarifat gjyqësore mund të bëhen pengesë për aksesin në gjykatë.

“Drejtësia nuk duhet të kushtojë. Kush do të marrë një avokat të shtrenjtë është i lirë ta bëjë këtë, por shteti vetë, nuk mund të kërkojë taksë të posaçme për procesin gjyqësor sepse gjyqësori mbahet me taksë”²³. Çështja e shpenzimeve gjyqësore mund të pengojë të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës, në rast se palët janë në pamundësi ekonomike. Në çështjet objekt monitorimi, situata e aksesit në drejtësi për shkak të pamundësisë ekonomike të palëve, paraqitet më

²² Shih: “Drejt Drejtësisë...” vep.cit., fq.100

²³ Gent Ibrahim, *Transparenca e gjykatave dhe vlerësimi i gjyqtarëve si instrumente për garantimin e besueshmërisë dhe pavarësisë së gjyqësorit*, kumtesë e botuar në “Reforma gjyqësore...”, vep.cit., fq. 53

shqetësuese në zgjidhjen e konflikteve të krijuara për shkak të diskriminimit, si dhe në kërkesat për shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga veprat penale të krimeve të dhunshme. Kjo për faktin se legjislacioni shqiptar ka parashikuar tarifa shumë të larta paraprake për gjykatën, të cilat shkojnë deri në 3% të dëmit të kërkuar. Gjithashtu, edhe tarifat gjyqësore për zgjidhjen e martesave rezultojnë mjaft të larta për gratë e dhunuara, të cilat nuk kanë asnjë të ardhur në prag divorci. Ndryshe paraqitet situata në lidhje me kërkesat për Urdhrat e mbrojtjes. Legjislacioni shqiptar, krijon aksesin falas për gjykimin dhe ekzekutimin e tyre. Në Ligjin “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, parashikohet e drejta e kërkuarit për t’u shkarkuar nga të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave për shpenzimet gjyqësore, si dhe ato të shërbimeve përmbartimore shtetërore. Me lëshimin e urdhrat të mbrojtjes, shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës që ka ushtruar dhunë në familje (neni 14.4 e ligjit). Edhe Komisioni Evropian në progres raportin 2012, për Shqipërinë, e ka shprehur këtë shqetësim, duke theksuar si vijon: “*Pak përparim është bërë në lidhje me aksesin në drejtësi. Zbatimi i ligjit “Për ndihmë juridike falas” ka qenë i ngadaltë për shkak të buxhetit të pamjaftueshëm dhe mungesës së koordinimit ndërmjet institucioneve përgjegjëse. Gjithashtu, nuk zbatohen me efektivitet as aktet nënligjore për rekrutimin e avokatëve të ndihmës juridike falas dhe as procedurat për kërkimin e ndihmës juridike falas. Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike ka trajtuar disa çështje, por ndërgjegjësimi për ligjin dhe shërbimet e Komisionit mbeten të pamjaftueshme, përfshi edhe rangun e nëpunësve shtetërorë që merren me kategoritë e cënueshme. Aksesin në drejtësi për kategoritë e cënueshme nuk është i garantuar, kryesisht për shkak të tarifave të larta të administrimit gjyqësor*”²⁴.

Ne monitoruam të gjitha shpenzimet gjyqësore për targetgrupin e grave që kërkojnë akses në drejtësi për çështjet e kërimit të dëmit të ardhur nga vepra penale, ose të dëmit të ardhur si pasojë e diskriminimit dhe konstatuam se situata rezulton si vijon²⁵:

²⁴ Komisioni Evropian, *Progres raporti 2012 për Shqipërinë*, Bruksel, më 10.10.2012, fq.19.

²⁵ Kjo situatë paraqitet deri në 25 Dhjetor 2012. Nga kjo ditë ka hyrë në fuqi Udhëzimi i Përbashkët Nr. 5668, dt.20.11.2013 “Për një ndryshim në Udhëzimin Nr. . nr. 13, datë 12.2.2009 ”Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për veprime dhe shërbime të administratës gjyqësore, ministrisë së drejtësisë, prokurorisë, Noterisë dhe Zyrës së Regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar. Ky udhëzim ka parashikuar tarifa të reja gjyqësore të cilat janë dukshëm zbritëse në raport me tarifat e përcaktuara nga udhëzimi i mëparshëm, por që sidoqoftë, kanë nevojë të diskutohen.

2.2. Çfarë lloj tarife duhet të paguajnë viktimat e veprave penale, ose viktimat e diskriminimit në një proces gjyqësor, për të kërkuar shpërblimin e dëmit?

Në këto raste e drejta për akses në gjykatë sigurohet me qëllim që këto viktima të dëmshpërblehen. Në legjislacionin shqiptar janë parashikuar mekanizmat për të kërkuar shpërblimin e dëmit në këto raste, si në legjislacionin civil edhe në atë penal²⁶. Por, që të kërkojmë një gjykim të drejtë dhe të hapur në këtë çështje, në radhë të parë duhet të eliminojmë pengesat financiare që paraqiten.

Konkretisht, në doktrinë dhe në parashikimet ligjore, nisur nga koha e pagimit të tyre, kemi një ndarje të shpenzimeve gjyqësore si vijon:

- shpenzime gjyqësore të bëra para gjykimit, ose paraprake;
- shpenzime gjyqësore gjatë gjykimit²⁷.

Realisht, kjo ndarje është kryer duke mbajtur si etalon rëndësinë që paraqesin shpenzimet gjyqësore për gjykatën dhe mbarëvajtjen e saj, por nuk është mbajtur parasysh pikënisja nga të drejtat dhe mundësitë e palëve ndërgjyqëse, për të cilët të dyja këto lloj shpenzimesh janë paraprake dhe e rëndojnë shumë pozitën e tyre financiare.

Ndërsa, nisur nga qëllimi për të cilat paguhen shpenzimet, doktrina ka një ndarje që merr parasysh edhe interesat e gjykatës edhe ato të palëve, duke i ndarë ato në:

- shpenzime gjyqësore për shërbimin e gjykatës
- shpenzimet gjyqësore për kryerjen e veprimeve procedurale ose shpenzime gjyqësore në kuptimin e ngushtë²⁸.

Edhe në këtë aspekt mendojmë se, klasifikimi është i cunguar, pasi në kompleks duhet të merren parasysh edhe shpenzimet përmbarimore.

Për të dhënë një pamje më të plotë të këtyre shpenzimeve, ne përgatitëm një skemë monitorimi duke i parashtruar të gjitha shpenzimet e mundshme.

²⁶ Për të njohur mekanizmat ligjorë dhe funksionimin e tyre shih: Aurela Anastasi, “Mekanizmat për dëmshpërblimin e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore dhe rëndësia e forcimit të tyre”, në “Jeta Juridike”, Nr. 2, Dhjetor 2009.

²⁷ Shih Rezarta Mataj, *Shpenzimet gjyqësore në procesin civil*, revista “Jeta Juridike”, nr. 1, Viti 2013

²⁸ Po aty.

Në bazë të legjislacionit aktual mund të rendisim këto shpenzime:

- a) Pagesa për regjistrimin e Kërkesëpadisë.
- b) Pagesa mbi vlerën e objektit të padisë.

Udhëzimi i Përbashkët të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Drejtësisë, nr. 13, datë 12.2.2009 *”Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për veprime dhe shërbime të administratës gjyqësore, ministrisë së drejtësisë, prokurorisë, Noterisë dhe Zyrës së Regjistrimit të pasurive të paluajtshme”*, vendos se, paditësi/ja që kërkon dëmin duhet të paguajë drejtpërdrejt, paraprakisht, 3% e vlerës së dëmit të kërkuar nëse kjo shumë është mbi 100 000 lekë, dhe 1% të shumës së kërkuar nëse kjo e fundit shkon deri në 100 000 lekë. Nga kjo shumë, 12000 lekë paguhet pranë sportelit të pranimeve të kërkesave në gjykatë për regjistrimin e kërkesëpadisë dhe pjesa e mbetur, paguhet pranë bankës përkatëse. Pagimi i shumës 12.000 lekë e tejkalon tarifën e kërkuar në rastin kur vlera e objektit të padisë është deri në 100000 lekë.

Pra, në këtë rast, nuk ka një ndarje të tarifës për shërbimin e gjykatës nga taksa mbi vlerën e objektit të padisë, që shpreh interesin e paditësit në të holla.

Nuk ka mekanizma për kthimin e shumës, ose për llogaritjen e shumës, prandaj ndodh që 2000 lekë të mos i kthehen asnjëherë paditësit në rastin kur vlera e kërkuar është deri në 100000 lekë.

- c) Pagesa për avokatin, kryhet sipas çmimeve në tregun e lirë. Nuk ka parashikime ligjore të posaçme për ofrimin e ndihmës ligjore *ex officio* për viktimat e veprës penale.
- d) Shpenzimet që kryhen për përgatitjen e provave (shpenzime noteriale, shpenzime hipotekore, tarifa të ndryshme, fotokopje, shpenzime për vizita mjekësore ose psikologjike etj.).
- e) Pagesa për shpenzimet paraprake të njoftimit;
- f) Pagesa për tërheqjen e vendimit origjinal (shpenzimet e pullave) (800 lekë, vetëm 1 kopje vendimi).
- g) Paraqitja e ankimit në vlerën 800 lekë.

- h) Shpenzimet për ekzekutimin e vendimit. Në bazë të ligjit nr. 8977, datë 12.12.2002 (i ndryshuar) *”Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”*, Lidhja nr.5 pika B, *”taksë për veprime që kryhen nga përmbaruesi gjyqësor”*, viktimë duhet të paguajë për ekzekutimin e vendimit shumën prej 3% të vlerës së vendosur nga gjykata. Tarifa paraprake tek përmbaruesi gjyqësor privat 20000 lekë.
- i) Tatimi mbi të ardhurën pas ekzekutimit të vendimit.

2.3. Si është aplikuar në rastet që ka asistuar QNL?

Rasti 1. Në rastin **me objekt shpërblimi i dëmit**, për viktimën e trafikimit të qenieve njerëzore D.S.²⁹, paditësja u përball me pagesat që vijnë:

1. Tarifë regjistrimi 12.000 Lekë, ose përafërsisht, 85.7 Eur.
2. Taksa e vlerës së objektit të padisë në vlerën 400 Eur.
3. Përgatitja e provave gjyqësore në vlerë të përafërt, 20 Eur.
4. Taksë vendimi në vlerë të përafërt, 800 lekë 5,7 Eur.
5. Parapagimi për përmbaruesin gjyqësor privat, 20000 lekë ose përafërsisht 142.8 eur.
6. Pagesa e Avokatit _____

Shuma gjithsej, 654.2 Eur ose përafërsisht, 92000 lekë, pa përfshirë **pagesën e avokatit**, pasi ndihma ligjore është dhënë falas. Nëse përfshijmë një pagesë minimale paraprake për pagesën e avokatit, sipas çmimeve të tregut, ajo do të ishte **500 Eur** dhe do të kishim gjithsej shuma **1154.2 Eur, ose**

Afati i gjykimit. Çështja ka filluar në vitin 2009 dhe statusi është vendim i formës së prerë, i paekzekutuar ende.

Rasti 2. Shpenzimet gjyqësore për një rast me objekt zgjidhje martesë, të dy bashkëshortëve, me dy fëmijë të lindur nga martesa³⁰.

1. Tarifë regjistrimi 9000 lekë.
2. Pagesa e psikologes 15000 lekë.

²⁹ Shih: Vendimi i Gjykatës së rrethit gjyqësor, Tiranë, nr.1202, dt. 19.02.2010.

³⁰ Shih: Vendim i Gjykatës së rrethit gjyqësor, Tiranë, nr. 4547, dt. 26.04.2013.

3. Përgatitja e provave gjyqësore në vlerë të përafërt, 400 lekë.
4. Taksë vendimi në vlerë të përafërt, 800 lekë.
5. Taksë njoftimi 200 lekë.
6. Pagesa e avokatit _____

Shuma gjithsej, 38.000 lekë, pa përfshirë pagesën e avokatit, pasi ndihma ligjore është dhënë falas. Nëse do të vendosnim një tarifë minimale për **pagesën e avokatit** sipas çmimeve të tregut ajo do të ishte **50000 mijë lekë** dhe do të kishim shumë **gjithsej 88000 lekë**.

Në lidhje me çështjet me objekt zgjidhje martesë, sikurse e kemi theksuar një pengesë më serioze përbëjnë pagesat e psikologëve. Ato paraqiten në rritje dhe për më tepër janë të paunifikuara. Nuk ka një përcaktim të kriterëve mbi bazën e të cilëve duhet bërë vlerësimi dhe vendosja e pagesës. Ato janë rastësore dhe gjatë monitorimit, sikurse e përmendëm edhe në kreun pararendës, ne nuk mund të gruponim dhe të përgjithësonim përvojat në lidhje me mënyrën e caktimit të psikologëve dhe shpenzimet për ta. Sidoqoftë, gjykojmë se ato lidhen kryesisht³¹:

1. Me numrin e fëmijëve të lindur nga martesa.
2. Me kërkesën e psikologut.
3. Me të ardhurat e bashkëshortëve që do të paguajnë raportin e psikologut.
4. Me vendodhjen e rrethit gjyqësor të gjykatës.

Duke monitoruar përvoja të gjykatave të rretheve të ndryshme gjyqësore ne evidentuam diferenca të mëdha. P.sh., në një rast të gjykuar në Gjykatën e rrethit gjyqësor Fier, ne konstatuam pagesën e psikologut 5000 mijë lekë. Ndërkohë, në një rast të gjykuar nga Gjykata e rrethit gjyqësor Tiranë, edhe pse nga martesa ka vetëm një fëmijë, pagesa e psikologut ka qenë 30000 lekë. Ky rast ka diferencë të madhe edhe me rastin e përfaqësuar nga Qendra jonë, në të cilin pagesa e psikologut ka qenë 15000 lekë, me dy fëmijë të lindur nga martesa. Natyrisht, që diferenca mund të ketë, por këto duhet të jenë të bazuara ligjërisht, me qëllim që të mos lihet shkas për abuzime.

3. Cilat janë mekanizmat dhe mundësitë që ofron legjislacioni shqiptar për t'u përjashtuar nga këto pagesa?

³¹ Vendim nr 1353, dt. 27.06.2012, i Gjykatës së rrethi gjyqësor Fier.

Mekanizmat që ofron legjislacioni shqiptar, për të siguruar aksesin në drejtësi të personave që nuk kanë të ardhura të mjaftueshme ekonomike, aktualisht, paraqiten si vijon:

1. Bazuar në legjislacionin procedural civil (neni 105/b, i KPr.C), gjykatat mund të ulin taksën gjyqësore në rrethana të veçanta, kur personi i përket një kategorie të caktuar që përjashtohet nga taksat. Por, që nga viti 2008, me miratimin e ligjit nr. 9975, dt. 28.07.2008, "Për taksat kombëtare", u shfuqizuan dispozitat e ligjit "Për taksat kombëtare", të vitit 2002, duke u abroguar edhe lehtësitë që parashikonte ai për kategori të caktuara, si personat me aftësi të kufizuara. Këto lehtësi nuk u parashikuan në ligjin e vitit 2008, ose nuk u lanë në fuqi prej tij. Kështu nuk ka asnjë mundësi mbi këtë bazë ligjore për përjashtime nga detyrimet financiare të palëve ndërgjyqëse, prej gjyqtarit.
2. Një mundësi e tillë është krijuar aktualisht, nga **Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të RSh, Nr.7, dt. 27.02.2013**. Në këtë vendim thuhet shprehimisht, "Megjithatë, Gjykata vlerëson se, në vështrim të neneve të sipërcituara të KPC-së, gjyqtari i zakonshëm nuk pengohet të hetojë dhe të përjashtojë paditësin nga pagesa e kësaj tarife, në rastet kur ndodhet përpara pamundësisë financiare të tij për të bërë këtë pagesë. Gjyqtari i zakonshëm ka hapësirë për të vlerësuar plotësimin e këtij kriteri procedural për ngritjen e padisë dhe për të bërë përjashtimet rast pas rasti, në mënyrë që të mos pengojë realizimin e të drejtës së aksesit në gjykatë. Sipas dispozitave procedurale civile, në rastet e përjashtimit të individit nga pagimi i shpenzimeve gjyqësore, ku përfshihet edhe taksa mbi aktet, këto shpenzime përballohen nga fondi përkatës i parashikuar në Buxhetin e Shtetit (neni 105/b).
3. Ligji nr. 10039, dt. 22.12.2008, "Për ndihmën juridike", parashikon kushtet dhe procedurat për dhënien e ndihmës juridike nga Shteti për personat që kanë nevojë për ndihmë juridike në çështjet civile ose administrative, por nuk kanë mjete të mjaftueshme për të paguar këtë ndihmë juridike. Për zbatimin e këtij ligji janë miratuar edhe disa akte të Komisionit Shtetëror të Ndihmës Juridike. Në vendimin e sipërcituar edhe Gjykata Kushtetuese i referohet këtij Komisioni duke vlerësuar detyrat e tij në këtë fushë. Ajo thekson: *"Nga ana tjetër, ligji nr. 10 039, datë 22.12.2008 "Për ndihmën juridike", ka përcaktuar një organ shtetëror kolegjal, Komisionin Shtetëror për Ndihmën Juridike, detyra kryesore e të cilit është t'u ofrojë ndihmë juridike kategorive të caktuara të*

*individëve, duke kryer shpenzimet përkatëse (nenet 10 dhe 14 të ligjit)*³². Mbetet detyrë e gjykatave zbatimi i këtij vendimi.

Problemet që evidentohen kanë të bëjnë me zbatimin e këtij ligji. Deri tani ligji ka pasur një zbatim të ngadalshëm. Edhe pse i miratuar në dhjetor të vitit 2008, vetëm në vitin 2012 kemi disa të dhëna për funksionimin e Komisionit të ndihmës juridike. Kështu, ai raporton për zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë më 15 shtator 2012, se janë nënshkruar kontrata me shtatë avokatë dhe katër Organizata Jofitimprurëse për ofrimin e ndihmës juridike, bazuar në vendimin nr. 90, datë 15.6.2012. Po në vitin 2012, Komisioni ka miratuar dhënien e ndihmës juridike për 8 raste (5 raste penale dhe 3 civile), si dhe ka miratuar kërkesën e TLAS, si OJF, për të ofruar ndihmë juridike specifikisht për komunitetin Rom, për 17 raste të regjistrimit të lindjeve me procedura administrative (me ndihmë juridike parësore) dhe 16 rasteve të kujdestarisë (me ndihmë juridike dytësore)³³.

4. Ligji nr. 9669, dt. 18.12.2006, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", parashikon të drejtën e kërkuarit për t'u shkarkuar nga të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave për shpenzimet gjyqësore, si dhe ato të shërbimeve përmbarimore shtetërore. Me lëshimin e urdhrit të mbrojtjes, shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës që ka ushtruar dhunë në familje (neni 14.4 e ligjit). Për zbatimin e këtij sanksionimi, përgjegjëse është Gjykata.

Gjithashtu, ligji parashikon të drejtën e viktimës që të ketë një asistencë ligjore falas. Për zbatimin e mirë të saj, ngarkohet Dhoma Kombëtare e Avokatisë dhe Komisioni Shtetëror i Ndihmës Juridike.

Konkluzione e Sugjerime

- Nga analiza e situatës konkludojmë se pagesat e taksave dhe tarifave gjyqësore janë të larta për disa kategori personash që kanë të ardhura të pakta ekonomike. Gratë në prag të divorcit janë gjithashtu vulnerabël.
- Tarifa paraprake që duhet të paguajë personi që kërkon shpërblimin e dëmit të ardhur nga vepra penale ose nga diskriminimi është shumë e lartë, joproporcionale dhe e

³² Shih: Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të RSh, Nr.7, dt. 27.02.2013.

³³ TLAS, Raport Mbi Ndihmën Juridike në Shqipëri, me mbështetjen e Civil Rights Defenders, Tirane 2012, fq.14.

paarsyeshme. Ajo rritet mbi bazën e dëmit të shkaktuar e të kërkuar gjë që e bën atë të paarsyeshme.

- Mekanizmat shtetërorë për përjashtimin ose lehtësimin për Ndihmën Juridike falas, janë të pamjaftueshme.

Sugjerime:

- Sugjerohet përcaktimi i tarifave për shërbimin e psikologut duke mbajtur parasysh edhe të ardhurat e palëve, përveç kriterëve të tjera.
- Të zbatohet vendimi i Gjykatës Kushtetuese dhe të hartohen komentare për zbatimin e këtij vendimi nga gjykatat, me qëllim që ato të shërbejnë për të gjithë praktikën gjyqësore.
- Të rriten mundësitë për bashkëpunimin e OJF-ve me Komisionin shtetëror të Ndihmës Juridike me qëllim zbatimin efektiv të ligjit "Për ndihmën Juridike".
- Të bëhet ministudim mbi efektivitetin e legjislacionit aktual mbi taksat gjyqësore në RSh dhe të vlerësohet ky legjislacion në lidhje me mundësitë që ofron për përjashtimet dhe lehtësimet tatimore të shtetasve nga taksat gjyqësore.
- Nga rezultatet e ministudimit të përgatiten paketat e nevojshme për ndryshim.

4. E drejta për të marrë njoftim ose për t'u thirrur për fillimin e seancës gjyqësore.

Ky element i të drejtës për akses është mjaft i rëndësishëm për garantimin e pjesëmarrjes në gjykim dhe për garantimin e zhvillimit të gjykimit me efektivitet. Theksojmë se është fjala për njoftimin apo thirrjen e palëve në momentin e fillimit të seancës gjyqësore dhe jo për njoftimin e datës dhe orës së saj, e cila u nënshtrohet procedurave të tjera. U nxitëm ta monitorojmë këtë çështje, pasi gjatë periudhës së monitorimit u kryen disa organizime në gjykatën objekt monitorimi. Konkretisht, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, u kryen riorganizime për rregullimin e ambienteve dhe menaxhimin më të mirë të hapësirave të gjykatës. Këto ndryshime kanë sjellë një situatë më të qetë pranë sallave të gjyqit dhe zyrave të gjyqtarëve ku zhvillohen gjyqet, pasi nuk lejohen qëndrime dhe grumbullime të qytetarëve pas dyerve, gjë që krijon qetësinë e përshtatshme për zhvillimin e procesit gjyqësor.

Nga prezenca e monitoruesve tanë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në pritje për monitorimin e seancave gjyqësore nga muaji shkurt 2012 e në vazhdim, është konstatuar se palët qëndrojnë në korridoret e Gjykatës në pritje për t'u thirrur nga sekretarja gjyqësore. 80% e monitoruesve konstatoi se situata e pritjes së palëve dhe e avokatëve në korridoret e Gjykatës, në pritje të fillimit të seancës gjyqësore nuk është e përshtatshme. Ka konfuzion dhe bëhet zhurmë, qytetarët dhe avokatët qëndrojnë në këmbë, në një hapësirë mjaft të ngushtë në krahasim me numrin e njerëzve që janë në pritje. Kontakti me gjyqtarin/en kryhet përmes thirrjes personalisht nga sekretarja gjyqësore pranë sportelit të rojës, por ka pasur raste kur vetë roja thërret palët pasi merr njoftimin me telefon. Po paraqesim disa komente të monitoruesve tanë në lidhje me këtë situatë: *“sekretaret gjyqësore njoftojnë me telefon rojën që qëndronte te dera e Gjykatës dhe që ai më pas të bënte njoftimin e palëve. Roja i bënte njoftimet, jo të sakta, me të meta, pasi kuptohej dukshëm që nuk i kujtonte emrat e palëve dhe nuk kishte saktësi në njoftim. Në disa nga rastet ai njoftonte vetëm një emër që mund të ishte paditësi ose i padituri në proces edhe këtë emër nuk e thoshte saktë. Gjithashtu, në asnjë rast roja nuk njoftonte se pranë cilit Gjyqtar/e do të zhvillohej seanca gjyqësore, ose ku ishte zyra (salla) ku do të zhvillohej gjykimi”*.

Më tej një monitorues komenton: *“Në një rast kur ne ishim në pritje, roja nuk ndodhej afër telefonit dhe zija e telefonit binte pambarimisht për disa minuta, menduam se ishte sekretarja gjyqësore që do të njoftonte për fillimin e procesit”*.

Monitoruesit shprehin shqetësim edhe për vështirësitë e hasura në dëgjimin e njoftimeve: *“Njoftimi bëhet me mikrofon, por ka raste që dëgjohet me shumë vështirësi, për shkak të zhurmës së lartë në korridore, ose për shkak të mosfunksionimit të mirë të teknikës”*.

Duke ndjekur situatën e aksesit fizik për fillimin e seancës gjyqësore, sipas organizimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nga Janari i vitit 2013, ne konstatojmë se kjo mënyrë organizimi në gjykatë nuk lejon zbatimin e nenit 174 të Kodit të Procedurës Civile, i cili parashikon: *Në ditën dhe orën e caktuar, palët ose përfaqësuesit e tyre janë të detyruar të njoftojnë gjykatën për praninë e tyre*. Kjo kërkesë e ligjit nuk mund të zbatohet me këtë mënyrë organizimi. Palët dhe avokatët nuk kanë akses për të njoftuar Gjykatën për praninë e tyre. Natyrisht, kjo nuk do të përbënte ndonjë shqetësim nëse kushtet do të ishin të atilla që të siguronin njoftimin e palëve për fillimin e seancës. Por, në fakt nuk ndodh gjithmonë kështu. P.sh., në çështjen me objekt lëshimin UMM me kërkesë të paditëses Ç.M., gjykata kishte caktuar

seancën e gjykimit në datën 25 janar 2013, ora 10.45. Por, po atë ditë ajo ka pushuar gjykimin me arsyetimin se paditësja, nuk ishte paraqitur. Në realitet Paditësja njoftoi avokatin se, kishte pritur për gjykim nga ora 10.30 deri në ora 13.00 dhe nuk kishte dëgjuar sekretaren gjyqësore ta thërriste për fillimin të procesit gjyqësor. Pasi u interesuan së bashku në sekretari, i kishin sqaruar se çështja e saj ishte pushuar, pasi paditësi nuk ishte paraqitur.

Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër janë konstatuar problematika që krijojnë vështirësi në marrjen e informacionit në kohë nga publiku dhe cenojnë transparencën e procesit. Kështu, listat e seancave gjyqësore janë afishuar në një hapësirë të pamjaftueshme, të vendosura mbi njëra tjetrën dhe shkrimi i tyre ka qenë shumë i vogël dhe thuajse i palexueshëm.

Në zbatim të neneve 179 dhe 299 të K. Pr. Civile, mosparaqitja e paditësit në proces sjell si pasojë juridike pushimin e gjykimit. Prandaj momenti i njoftimit të palëve për fillimin e seancës duhet të organizohet e të menaxhohet me shumë kujdes nga gjykata, pasi ndikon drejtpërdrejt në pengimin e aksesit të palëve për të marrë pjesë në seancë, si dhe për të pasur një proces të drejtë e të hapur. Nga ana tjetër, ai sjell impakt edhe në efektivitetin e punës së gjykatës, pasi lidhet me mbarëvajtjen e procesit gjyqësor dhe rrit fiktivisht numrin e pushimit të çështjeve nga gjykata.

Për sa më sipër sugjerojmë:

1. Të rishikohet mënyra e zbatimit të nenit 174 të Kodit të Procedurës Civile dhe të realizohet mundësia e palëve për të njoftuar prezencën, ose të ndryshohet ligji në mënyrën më efektive.
2. Të krijohen ambiente të përshtatshme për avokatët që presin, me qëllim që ata të marrin njoftim të sigurtë për fillimin e seancave gjyqësore.
3. Të krijohen ambiente të përshtatshme për palët që presin, me qëllim që ata të marrin njoftim të sigurtë për fillimin e seancave gjyqësore.
4. Thirrja e palëve për fillimin e procesit gjyqësor në korridoret e Gjykatës të jetë i kuptueshëm dhe të komunikohet emri i gjyqtarit, si dhe ambienti ku do të zhvillohet gjykimi.
5. Të bëhet kujdes për përpunimin e të dhënave në database, me qëllim që ato të japin të saktë orën dhe fazat e zhvillimit të seancës.

6. Mendojmë se gjykata duhet të riorganizojë njoftimet në mënyrë të tillë që avokati dhe pala të kenë më shumë se një alternativë njoftimi.
7. Mendojmë se thirrja e palëve për UMM duhet të ketë një më shumë se një alternativë të sigurtë.

IV. EFEKTIVITETI I PROCESIT GJYQËSOR


Efektiviteti i procesit gjyqësor është një fenomen kompleks që përbëhet nga disa elementë e faktorë të rëndësishëm. Por, në këtë proces monitorimi, ai është parë i lidhur ngushtë me kohëzgjatjen e gjykimeve, zbatimin e afateve procedurale dhe shfrytëzimin efektiv i kohës. Vëzhgimet tona u përqendruan në kohëzgjatjen e çështjeve me objekt zgjidhjen e konflikteve familjare. Kjo, pasi ne dëshironim të kishim një bazë përgjithësuese për të arritur në konkluzione të vlefshme. Në lidhje me përfundimin e gjykimeve ne nuk mund të arrinim në konkluzione, për shkak të natyrës së këtij monitorimi, i cili u përqendrua veçanërisht në monitorimin e seancave gjyqësore.

Në vijim po përmbledhim disa të dhëna statistikore me qëllim që të shohim numrin e seancave gjyqësore dhe kohëzgjatjen e tyre. Në këtë kuadër, një rëndësi të posaçme paraqet studimi i shkaqeve të shtyrjes së seancave gjyqësore, zbulimi i të cilave do të na japë mundësi për të përmirësuar punën më tej.

1. Kohëzgjatja e gjykimeve në çështjet me objekt Zgjidhje Martese, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë janë monitoruar gjithsej 29 seanca gjyqësore, në 24 çështje me objekt zgjidhje martese. Këto raste janë monitoruar duke filluar nga data e regjistrimit të çështjes në Gjykatë, deri në datën e dhënies së vendimit, kurse për çështjet që vazhdojnë të jenë në proces deri në datën e seancës së fundit të caktuar nga Gjykata.

- **Kohëzgjatja dhe numri i seancave gjyqësore për çështjet me objekt zgjidhje martese që kanë rezultuar të përfunduara deri në datën 20 maj 2013.** Nga 24 çështje të monitoruara, 16 prej tyre kanë rezultuar të përfunduara brenda periudhës së monitorimit, me numrin e seancave gjyqësore, siç paraqitet në Grafikun që vijon:

Grafiku nr. 1.

Në tabelën e mëposhtme paraqitet kohëzgjatja e seancave gjyqësore për çështjet me objekt zgjidhje martesë të përfunduara, sikurse janë paraqitur në grafikun nr. 1.

Tabela nr. 1


Kohëzgjatja dhe numri i seancave gjyqësore për çështjet me objekt zgjidhje martesë të përfunduara, GJRGJ Tiranë (16 çështje)			
Data e regjistrimit	Seanca gjithsej	Data e vendimit	Kohëzgjatja
22.04.2011	5 seanca	20.03.2012	10 muaj e 26 ditë
21.09.2011	13 seanca	22.04.2013	1 vit e 7 muaj
27.09.2011	3 seanca	09.03.2012	5 muaj e 10 ditë

04.11.2011	3 seanca	09.05.2012	6 muaj e 5 ditë
01.03.2012	4 seanca	03.10.2012	7 muaj e 2 ditë
08.03.2012	6 seanca	07.06.2012	3 muaj
11.05.2012	3 seanca	13.11.2012	6 muaj e 2 ditë
21.06.2012	4 seanca	29.04.2013	10 muaj e 8 ditë
11.09.2012	3 seanca	05.11.2012	1 muaj e 26 ditë
12.09.2012	6 seanca	10.04.2013	7 muaj
08.11.2012	8 seanca	07.05.2013	6 muaj
09.11.2012	5 seanca	26.04.2013	5 muaj e 17 ditë
04.12.2012	4 seanca	11.04.2013	4 muaj e 7 ditë

10.12.2012	4 seanca	02.05.2013	4 muaj e 22 ditë
18.01.2013	2 seanca	29.04.2013	3 muaj e 11 ditë
07.02.2013	6 seanca	01.04.2013	1 muaj e 24 ditë

Nga të dhënat e tabelës më sipër rezulton se kohëzgjatja më e mirë e çështjeve gjyqësore me objekt zgjidhje martesë është nga 1 deri në 3 muaj, kurse kohëzgjatja mesatare është nga 4 deri në 7 muaj. Për ta kuptuar më mirë këtë përfundim mund të shohim Grafikun Nr. 2, si më poshtë:

Grafiku nr.2




Në të njëjtin konkluzion do të arrinim edhe nëse vëzhgonim të dhënat që rezultojnë nga monitorimi i çështjeve që ishin ende në proces, të cilat janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.


Tabela nr.2

Kohëzgjatja dhe numri i seancave gjyqësore për çështjet me objekt zgjidhje martesë në proces, GJRGJ Tiranë, (8 çështje)			
Data e regjistrimit	Seanca gjithsej	Seanca e fundit	Kohëzgjatja
14.11.2011	10 seanca	06.06.2013	1 vit e 6 muaj e 23 ditë
25.11.2011	11 seanca	03.06.2013	1 vit e 6 muaj e 9 ditë
23.04.2012	11 seanca	22.05.2013	1 vit e 1 muaj
13.06.2012	8 seanca	13.06.2013	1 vit
09.10.2012	5 seanca	03.06.2013	7 muaj e 25 ditë
16.01.2013	3 seanca	04.06.2013	4 muaj e 19 ditë

28.01.2013	3 seanca	29.05.2013	4 muaj
04.02.2013	3 seanca	06.06.2013	4 muaj e 2 ditë

Grafiku Nr. 3



Grafiku nr.4

Duke përmblledhur të gjitha të dhënat sa më sipër, na rezulton:

1. Kohëzgjatja mesatare e një çështjeje me objekt zgjidhje martese është nga 4-8 muaj.
2. Kohëzgjatja më e madhe për përfundimin e një çështjeje me objekt zgjidhje martese është nga 12 deri në 19 muaj.
3. Numri i seancave gjyqësore që qëndrojnë në nivel mesatar është 5-8 seanca gjyqësore për një çështje.
4. Numri më i lartë i seancave gjyqësore të mbajtura është 13 seanca gjyqësore.
5. Mesatarisht, koha midis dy seancave shtrihet nga 1-1muaj e gjysmë.

Konkluzione:

Duke pranuar si afat të arsyeshëm kohëzgjatjen mesatare të nxjerrë nga koha e çështjeve, mesatarisht, mund konkludojmë se perioda mbi 10 muaj është një afat i paarsyeshëm.

Për të kuptuar se si mund të përmirësohet kjo, kemi nevojë të analizojmë shkaqet për shtyrjen e seancave gjyqësore, të cilat po i paraqesim në vijim.

- **Shkaqet për shtyrjen e seancave gjyqësore.**

Nga 29 seanca të monitoruara, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë në 20 prej tyre janë shtyrë seancat gjyqësore. Shkaqet e evidentuara nga monitoruesit janë përmbledhur në tabelën që vijon:

Tabela nr. 3

Shkaqet e shtyrjes së seancave gjyqësore			
Gjyqtari nuk është prezent	Përgatitja e raportit nga eksperti psikolog	U la kohë për saktësimin e adresave të palëve	U la kohë për paraqitjen e provave
5 seanca	11 seanca	1 seancë	3 seanca


Nga tabela e mësipërme konstatojmë se, numri më madh i seancave të shtyra është bërë për t'i lënë kohë ekspertit psikolog që të përgatisë raportin, e ndjekur nga mungesa e gjyqtarëve, dhe më tej për t'u lënë kohë palëve për paraqitjen e provave.

Mendojmë se rasti i parë duhet të dallohet nga tri rastet e tjera. Shtyrja e seancës gjyqësore pas caktimit të ekspertit, me qëllim që ky i fundit të ketë kohën e nevojshme për të paraqitur raportin, është një domosdoshmëri procedurale. Tri rastet e tjera mendojmë se janë të evitueshme me një organizim e menaxhim më të mirë të punës në gjykata.

2. Kohëzgjatja në çështjet me objekt UM dhe UMM.

Në gjykimin e çështjeve për lëshimin e urdhrave të mbrojtjes Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë zbaton afatet procedurale të veçanta që janë parashikuar në Ligjin “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”. Monitorimi i Urdhrave të mbrojtjes në këtë këndvështrim, është kryer në periudhën shkurt 2012-Maj 2013. Janë monitoruar gjithsej, 31 seanca gjyqësore, sipas objektit që vijon:

Grafiku nr. 5



- Si zbatohen afatet e gjykimit në UM/UMM?

Për të evidentuar të dhënat që do të vijojnë, është parë analizuar edhe *database* i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe është evidentuar fillimi dhe përfundimi i çështjes, si dhe numri i seancave gjyqësore.

Nga monitorimi ka rezultuar:


Në gjykimin e UM dhe UMM, afati i parashikuar në ligj përkatësisht për to, është zbatuar për fillimin e gjykimit, por jo për përfundimin e tij.

- Në rastin e lëshimit të UMM, Gjykata duhet të zbatojë afatin e parashikuar në ligj, brenda 48 orëve për viktimat madhore dhe 24 orëve për të miturit, që përballen me dhunë në marrëdhëniet familjare. Por, ka raste që këto afate nuk zbatohen. Konkreisht, nga 11 raste të monitoruara me këtë objekt, në gjashtë raste nuk është zbatuar ky afat, nga të cilat në katër raste Gjykata ka përfunduar gjykimin tej afatit 48 orë në kundërshtim me afatin e caktuar nga LDHF. Madje, në dy raste gjykimi ka filluar mbas mbarimit të afatit 48 orë.
- Nga 8 çështje në fazën e vërtetimit të UMM ka rezultuar se në 4 raste Gjykata ka caktuar datën e verifikimit të UMM, tej afatit 20 ditore të caktuar nga neni 19 i LDHF.

- c) Nga 11 çështje të monitoruara me objekt lëshimin e UM, për shqyrtimin e të cilit ligji ka parashikuar një afat 15-ditor, ka rezultuar se në 8 raste Gjykata, nuk ka filluar shqyrtimin e kërkesës edhe pse kanë kaluar 15 ditë nga dita e regjistrimit të kërkesës.

Në mënyrë të përmblëdhur këto të dhëna janë pasqyruar në Grafikon nr.6.

Grafiku nr. 6



Për sa më sipër, rezulton se duhet të analizojmë shkaqet se përse Gjykata e ka më të vështirë të zbatojë afatet në lëshimin e urdhrave të Mbrojtjes, me një afat 15-ditor, se sa afatin 48 orë për lëshimin e urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes. Përpara se të nxjerrim konkluzionet, është e nevojshme të studiojmë edhe të dhëna të tjera.

Në këtë mënyrë mund të shohim saktësisht se si zbatohen nga Gjykata afatet ligjore për zbatimin e tyre, sipas tabelave në vijim.

Tabela nr.4

Kohëzgjatja e proceseve gjyqësore për çështjet me objekt lëshimin e UM (gjithsej 11 seanca të monitoruara).		
Regjistrimi i çështjes në	Data e vendimit të UM	Kohëzgjatja

Gjykatë		
20.10.2011	20.02.2012	120 ditë
23.4.2012	8.5.2012	15 ditë
25.5.2012	4.7.2012	41 ditë
18.12.2012	1.2.2013	46 ditë
18.12.2012	1.2.2013	46 ditë
11.1.2013	11.2.2013	30 ditë
11.1.2013	11.2.2013	30 ditë
28.1.2013	1.3.2013	35 ditë
31.1.2013	22.4.2013	82 ditë
15.3.2013	2.5.2013	49 ditë
15.3.2013	2.5.2013	49 ditë

Tabela nr.5

Kohëzgjatja e proceseve gjyqësore për çështjet me objekt vërtetimin e UMM (8 seanca të monitoruara gjithsej)		
Data e vendimit të UMM	Data e vërtetimit të UMM dhe lëshimit të UM	Kohëzgjatja
14.8.2012	14.9.2012	31 ditë
18.12.2012	17.1.2013	30 ditë
3.9.2012	1.11.2012	59 ditë

6.9.2012	10.10.2012	25 ditë
1.3.2013	7.5.2013	68 ditë
2.3.2013	23.3.2013	20 ditë
7.3.2013	4.4.2012	28 ditë
8.2.2013	4.6.2013 (në proces)	120 të

3. Shkaqet e shtyrjes së seancave gjyqësore.

Nga 31 seanca të monitoruara në 12 prej tyre janë shtyrë seancat gjyqësore. Në disa raste, gjykata zbaton faza procedurale që nuk parashikohen në ligjin LDHF, pasi zbaton edhe veprime procedurale që parashikohen në KPr.C. Kështu, p.sh., në 3 raste, nga rastet e monitoruara, gjykata ka zhvilluar seanca përgatitore. Në disa raste është bërë shkak për vonesë përfshirja e psikologut, e cila nuk është parashikuar nga ligji. Sidoqoftë, shkaqet e evidentuara nga monitoruesit janë përmbledhur në tabelën që vijon:

Tabela nr.6

Shkaqet e shtyrjes së 12 seancave gjyqësore te monitoruara me objekt um/umm	
Paditësi ka bërë kërkesë për tu mbrojtur me avokat	1
Seanca është shtyrë për të sjellë prova palët	4
Psikologja duhet të paraqiste raportin psikologjik të bisedës me fëmijën e mitur	1
Psikologja jo prezente	1
Palët duhet të paraqesin prova për pronën	2
Gjyqtarja kërkoi pretendimet me shkrim	1

Njoftimi i palës së paditur	1
Njoftimi i paditëses	1

Për sa më sipër, duke studiuar kohën që i është dashur Gjykatës, si dhe shkaqet për të cilat janë shtyrë seancat gjyqësore në këto çështje, ne mund të nxjerrim konkluzione për të cilat pretendojmë të diskutohen dhe të merren në konsideratë nga gjykata. Ndërkohë, këto të dhëna na japin mundësi të nxjerrim konkluzione edhe për institucione të tjera ndihmëse.

Kështu p.sh., në rast se themi se, më shumë seanca (gjithsej 4) janë shtyrë për shkak se palët nuk kanë sjellë provat e mjaftueshme, atëherë nxjerrim detyra jo vetëm për palët dhe gjykatën, por edhe për institucionet e tjera të rrjetit përgjegjës kundër dhunës në familje, veçanërisht policinë, qendrat shëndetësore, Institutin e Mjekësisë Ligjore etj.

Sidoqoftë, nisur nga të gjitha sa parashtruam më lart, evidentojmë këto përfundime:

1. Konkludojmë se, mospërgatitja në kohë e provave bëhet shpesh pengesë për shtyrjen e gjykimeve. Kjo është arsyeja që ka më shumë raste të tejkalimit të afateve ligjore më tepër tek UM me një afat 15 ditor, sesa të UMM, me afat 48 orë. Thirrja e psikologut në proceset gjyqësore për urdhrat e mbrojtjes dhe urdhrat e menjëhershëm të mbrojtjes, nuk është parashikuar nga LDHF drejtpërdrejt. Megjithatë, nëse gjyqtari e çmon se është e nevojshme, nuk duhet të bëhet shkak psikologu për shtyrjen e seancave gjyqësore.
2. Kërkesa e gjykatës për të kërkuar prova në lidhje me shtëpinë pronë, na duket e pavend, pasi këto prova nuk nevojiten në këtë objekt gjykimi.
3. Zbatimi i fazave të tjera procedurale, si p.sh., seanca përgatitore, të cilat nuk janë parashikuar nga LDHF, ka sjellë vonesa të panevojshme në lëshimin e urdhrave të mbrojtjes.
4. Nuk na duket me vend që në urdhrat e mbrojtjes, seanca të shtyhet me arsyen që palët të sjellin pretendimet me shkrim. Gjykime kaq të shpejta nuk e presupozojnë shtyrjen në këto raste. Madje, ne mendojmë që palët duhet t'i kenë përgatitur më parë pretendimet.

Sugjerime:

1. Të gjitha organet përgjegjëse kundër dhunës të kujdesen që provat të përgatiten paraprakisht dhe jo në ditët e gjykimit. Subjekti që ndihmon viktimën për të përgatitur kërkesën (Policia, OJF-ja, avokati, etj.) ta shoqërojë kërkesën me provat përkatëse paraprakisht. Këto detyra duhet të kryhen nga të gjitha organet e rrjetit kundër dhunës dhe avokatët.
2. Lind serish nevoja për një institucionalizim të psikologëve dhe punonjësve socialë, me qëllim që kur gjyqtari e çmon të arsyeshme, psikologu të përgjigjet në një periudhë të shkurtër kohe.
3. Do të ishte e dobishme që, kur viktima ndihmohet nga institucione që kanë mundësi, këto të fundit të përgatisin një raport me faktet që disponojnë, ose një raport të psikologut kur është nevoja veçanërisht për dhunën ndaj fëmijëve, dhe ta dorëzojnë atë së bashku me kërkesëpadinë. Kjo do ta ndihmonte shumë gjykatën që të mos humbë afatet e gjykimit.
4. Shërbimi i psikologëve për viktimat e dhunës në familje duhet të sigurohet falas.
5. Është e nevojshme që të zbatohet nga gjykata edhe rregullimi i shpenzimeve gjyqësore në ngarkim të dhunuesit me qëllim që të funksionojë instituti i mbrojtjes falas dhe i psikologëve falas.
6. Ka nevojë ende që të gjithë gjyqtarët dhe aktorët e tjerë të rrjetit të trajnohen mbi procedurat e veçanta që kanë gjykimet mbi lëshimin e UM dhe UMM.

V. SOLEMNITETI DHE SJELLJA E GJYQTARIT GJATË SEANCAVE GJYQËSORE

Solemniteti dhe sjellja korrekte e gjyqtarit gjatë seancave gjyqësore janë aspekte shumë të rëndësishme të etikës së gjyqësorit. *Gjyqtarët duhet që të jenë në çdo rast të kthjellët dhe të qartë për të përmbushur detyrën e tyre në respekt edhe të reputacionit të Gjykatës*³⁴. Ato duhet të tregojnë aftësitë e tyre për të dëgjuar, komunikuar dhe drejtuar seancën. Të lidhura edhe me aspektet e tjera të etikës gjyqësore, ato ndihmojnë në rritjen e besueshmërisë së publikut ndaj gjyqësorit, përmes rritjes së nivelit të integritetit të gjyqtarit. Prandaj, solemniteti dhe korrektesa e sjelljes së gjyqtarit gjatë seancave gjyqësore, si dhe solemniteti i gjykatës në përgjithësi, u bënë objekt i posaçëm monitorimi.

Në procesin kërkimor ne evidentuam edhe monitorime të tjera që ishin kryer me këtë subjekt nga shoqëria civile, por ato ishin përqendruar në gjykimet penale dhe në periudha më të hershme monitorimi³⁵. Sidoqoftë, këto monitorime janë shumë të rëndësishme si një bazë e mirë krahasimore, si dhe për të parë zhvillimin e situatës me kalimin e kohës. Disa nga këto kritere janë pjesë e vlerësimit profesional dhe etik të gjyqtarëve në sistemin e vlerësimit të KLD-së³⁶. Megjithatë, ne kemi bërë kujdes që të mos mbivendosemi mbi kontrollin institucional, sikurse është zhvilluar nga KLD-ja. Sidoqoftë, të dhënat e nxjerra nga ky monitorim mund të shërbejnë për çdo institucion, ose për shoqërinë civile.

4. Solemniteti i seancave gjyqësore.

1.1. Ambienti ku zhvillohet gjykimi.

Nga pikëpamja e solemnitetit, përpos elementëve të tjerë ka një rëndësi të posaçme edhe **ambienti ku do të zhvillohet gjykimi**. Madje, në vendimin nr. 238, datë 24.12.2008 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë (KLD) vendoset se, përse është e mundur, të gjitha seancat gjyqësore duhet të zhvillohen në salla gjykimi të përshtatshme për natyrën e çështjes konkrete. Por, në fakt, nga

³⁴ Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut të Këshillit të Evropës, Rezoluta për etikën gjyqësore, Shkurt 2013, paragrafi 3.

³⁵ Shih: Komiteti Shqiptar i Helsinkit, “Raport për monitorimin e rregullshmërisë së proceseve gjyqësore”, botuar në faqen zyrtare: http://www.ahc.org.al/site/doc/Raport_gjyqesor_shkurt%202012.pdf, vizituar për herë të fundit, më 26.08.2013.

³⁶ Sistemi i vlerësimit profesional dhe etik i gjyqtarëve dhe Vendimi i KLD-së Nr.199/3, dt. 15.09.2006, “Mbi kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”.

monitorimi i seancave gjyqësore objekt i këtij studimi, ka rezultuar se në pjesën më të madhe të rasteve gjykimi zhvillohet në zyrat e gjyqtarit dhe jo në sallë.

Kështu, nga 100 seanca të monitoruara në procesin civil, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë janë zhvilluar në zyrën e gjyqtarit 97 seanca gjyqësore dhe vetëm 3 seanca gjyqësore janë zhvilluar në sallat e gjyqit. E njëjta situatë ravijëzohet edhe në procesin penal.


Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër nga 69 seanca të monitoruara gjithsej, në 2 raste seanca gjyqësore është zhvilluar në sallë dhe në 67 raste seanca gjyqësore është zhvilluar në zyrë.

Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan nga 142 seanca të monitoruara ka rezultuar se në 100% të rasteve, seancat janë zhvilluar në zyrat e gjyqtarëve.

Ndërsa, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë nga monitorimi ka rezultuar se të gjitha seancat gjyqësore janë zhvilluar në sallë, kjo edhe për shkak të përmirësimit të infrastrukturës dhe kushteve të përshtatshme që janë krijuar.


Më poshtë mund të shohim këtë raport përmes grafikëve që vijojnë (Grafiku 1, 2):

Grafiku Nr.1.



Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë nga 5 seanca të monitoruara në procesin penal, 4 prej tyre janë zhvilluar në zyrën e gjyqtarit, dhe vetëm një seancë është zhvilluar në sallë.

Grafiku nr. 2



A janë zyrat e gjyqtarit të përshtatshme për të zhvilluar gjykimin?

Në komentet e tyre monitoruesit në Gjykatat e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Elbasan e Shkodër, theksojnë faktin se, në të gjitha seancat gjyqësore që janë zhvilluar në zyrat e gjyqtarëve, palët janë vendosur në kushte të papërshtatshme, pasi ambienti është shumë i vogël. Mundësia e vetme e qëndrimit është që, njëra palë të qëndrojë shumë afër Gjyqtarit dhe pala tjetër afër derës së zyrës. Gjithashtu, nuk ka kushte të përshtatshme edhe për avokatin, pasi mungojnë tavolinat. Këta të fundit, shpesh detyrohen që dosjet dhe dokumentet e nevojshme, t'i lënë në tokë.

Konkluzioni: Janë të nevojshme ndryshimet infrastrukturore me qëllim që të zgjerohen hapësirat për sallat e gjyqit, si dhe për zyrat e gjyqtarëve.

1.2. Solemniteti në paraqitjen e jashtme dhe qëndrimin e gjyqtarit.

Paraqitja e jashtme e gjyqtarit, veshja e tij profesionale, si dhe qëndrimi gjatë procesit, lidhen ngushtë me solemnitetin në seancat gjyqësore dhe janë të nevojshme për besueshmërinë ndaj procesit gjyqësor.

Konkretisht, nga monitorimi i paraqitjes së jashtme të gjyqtarit, përmes veshjes së uniformës së tij, patëm këto rezultate: Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë nga 100 seanca gjyqësore civile të monitoruara, në 40 prej tyre, ka rezultuar se Gjyqtari ka gjykuar pa uniformën e gjyqtarit.


Kurse, në procesin penal, nga 5 seanca të monitoruara, ka rezultuar se në 4 prej tyre, gjyqtarët kanë gjykuar pa uniformën e gjyqtarit.

Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, nga 142 seanca gjyqësore vetëm në 6 raste gjyqtarët kanë gjykuar të veshur me uniformën e gjyqtarit.

Ndërsa, në Gjykatën e rrethit gjyqësor Shkodër, në 100 % të seancave të monitoruara gjyqtarët kanë gjykuar me uniformë. Edhe në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, ka rezultuar se në të gjitha seancat e monitoruara gjyqtarët kanë gjykuar me uniformën e gjyqtarit.

Pra, gjithsej, situata paraqitet si më poshtë:

Grafiku Nr.3



Ndërkohë, monitoruesit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë kanë komentuar faktin se, në asnjërën prej seancave gjyqësore të monitoruara në Gjykatën e Shkallës së parë, nuk ka pasur avokat të veshur me uniformën përkatëse. Për më tepër, avokatët nuk kanë një ambient të veçantë për të qëndruar në pritje të seancave gjyqësore.

Solemniteti i gjyqtarit duket edhe në qëndrimin dhe veprimet e tij gjatë seancës gjyqësore. Nga 105 seanca të monitoruara në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në 32 prej tyre, monitoruesit kanë raportuar se janë ndërprerë seancat, pasi gjyqtarët flisnin në telefon për çështje personale, porositnin kafe, ushqim, etj.

- Situata të tilla janë raportuar edhe nga monitoruesit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe Shkodër. Monitoruesit në këto gjykata të rretheve gjyqësore, shprehen: *“Janë vërejtur raste që seanca gjyqësore të ndërpritet për shkak të zileve të celularëve të gjyqtarëve, avokatëve, palëve në gjykim por dhe për shkak të hyrjes së personave të ndryshëm në zyrën e gjyqtarit.”*

Nisur nga konkluzionet si më sipër, sugjerojmë:

1. Ka nevojë për ambiente të reja me qëllim sigurimin e kryerjes së seancave gjyqësore në sallat e gjyqit. Zyrat e gjyqtarëve duhet të jenë më të gjera që të mund të përdoren edhe për gjykimin në seancë gjyqësore.
2. Gjyqtarët duhet ta respektojnë rregullin për të qëndruar me uniformë gjatë procesit gjyqësor.
3. Duhet të ndalohet kategorikisht përdorimi i celularit gjatë seancave gjyqësore.
4. Të bëhet rregull një periudhë pushimi pas çdo seance gjyqësore, me qëllim që gjyqtarët të përfundojnë komunikime të ndryshme jashtë seancave ose urgjenca personale.

2. Etika profesionale.

Në pyetësin monitorues, 50% e pyetjeve u adresuan mbi etikën profesionale të gjyqtarëve dhe konkretisht, në paraqitjen e tyre lidhur me komunikimin dhe dëgjimin ndaj palëve ndërgjyqëse, në drejtimin e procesit gjyqësor dhe përdorimin e njohurive juridike.


Në shtojcën e këtij studimi ne mund të njihemi edhe me rezultatet e detajuara, por sidoqoftë, për të arritur në disa konkluzione në lidhje me zbatimin e etikës profesionale, mund të përgjithësojmë disa prej të dhënave të dala nga monitorimi.

2.1. Komunikimi, dëgjimi e kujdesi ndaj palëve.

Me këtë kriter ne kemi kuptuar përdorimin nga gjyqtari të normave të larta të sjelljes në komunikimin me palët dhe respektimin e pjesëmarrësve në proces. Monitoruesit iu përgjigjën disa pyetjeve, nga të dhënat e të cilave mund të nxjerrim konkluzione të rëndësishme për përmirësimin e punës në këtë aspekt.


Kështu p.sh., pyetjes: **A u kushtoi Gjyqtari vëmendje të gjitha palëve?** Monitoruesit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë u përgjigjën në 80 raste **po**, në 13 raste **jo** dhe në 12 raste, nuk dhanë përgjigje.

Grafiku nr. 4.



A i trajtoi gjyqtari palët me mirësjellje dhe respekt? Për këtë pyetje, 63.8% e monitoruesve u përgjigjën po, kurse 5.71% e tyre u përgjigjën jo. Në këtë rast, një pjesë e madhe e monitoruesve nuk janë përgjigjur dhe nuk kanë komentuar (30.47% e tyre).

Grafiku nr. 5




Për të kuptuar këto opinione të monitoruesve ne adresuam komentet e tyre dhe konstatuam se, nga 105 seanca gjyqësore të monitoruara, në 24 prej tyre ata kishin komentuar se gjyqtari gjykon duke shfaqur nervozizëm, ofendon palët dhe avokatët, duke përdorur ton fyes. (Disa nga këto komente janë paraqitur edhe në kapitujt e mësipërm).

Konkluzion: Mesatarisht, në vetëm 12% të rasteve kemi raportim se gjyqtari nuk u kushtoi vëmendje palëve, ose iu drejtua atyre me ton fyes. Megjithatë, është e nevojshme që këto raste të minimizohen. Kjo i shërben jo vetëm solemnitetit, por edhe paanshmërisë si dhe rritjes së respektit të palëve për gjykatën.

2.2. Drejtimi i procesit gjyqësor.


Për të kuptuar këtë aspekt, ne iu drejtua doktrinës, si dhe kriterëve të vlerësimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Me këtë kriter vlerësohet aftësia e gjyqtarit për të drejtuar një proces të rregullt gjyqësor, pra mbi bazën e procedurave përkatëse (1) për të drejtuar dhe orientuar drejt debatin gjyqësor (2) duke u shprehur qartë dhe me lehtësi, (3) në përputhje me rregullat që parashikon ligji dhe etika gjyqësore. Në monitorim ne u përqendruam në dy standardet e fundit dhe adresuam disa pyetje në lidhje me to. Kështu p.sh., pyetjes se, **A arriti gjyqtari të mbante nën kontroll sallën e gjyqit?** Të dhënat e përgjigjeve të monitoruesve janë përmbledhur në Grafikun nr.6.

Grafiku nr. 6.



Pyetja tjetër e lidhur me këtë aspekt: **A kishte në sallën e gjyqit qetësi dhe rregull?** mori përgjigje të ngjashme, sikurse pasqyrohet në grafikun nr.7.

Grafiku nr.7






Pra, në 83 % të rasteve gjyqtari ia doli mbanë të kontrollonte sallën e gjyqit, duke mbajtur qetësi dhe rregull.

Për të parë se sa gjyqtari me menaxhimin që i bën seancës gjyqësore u krijon mundësi palëve të kuptojnë dhe të marrin pjesë në seancë, ne drejtua një grup pyetjesh, disa prej të cilave po i paraqesim në vijim grafikisht me gjithë përgjigjet që morëm.

Në lidhje me përgjigjet për pyetjen: **A foli Gjyqtari me zë të lartë dhe qartë?** Shih grafikun nr. 8.

Grafiku nr. 8.



Grafiku nr. 9 -A u bëri Gjyqtari shpjegime pjesëmarrësve?**Grafiku nr. 10. -A i kuptuan të gjithë të pranishmit thëniet e gjyqtarit?**

Sikurse shihet nga grafikët më sipër, janë evidentuar një përqindje e vogël rastesh, në të cilat palët nuk kanë kuptuar shpjegimet e gjyqtarit dhe një përqindje më e madhe ku pranohet se gjyqtarët nuk bënë fare shpjegime. Një aspekt tjetër i drejtimit të seancës gjyqësore lidhet edhe me frymën që përcjell gjyqtari me fjalët që thotë. Gjyqtari nuk mund të përcjellë përmes fjalëve

të tij mungesë besimi tek vetë gjykata, procesi dhe vendimi që del prej saj. Nga monitorimi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka rezultuar se, ka raste kur Gjykata ka reflektuar mungesë besimi dhe këtë mungesë besimi ua ka transmetuar edhe palëve. Kështu, psh., në seancën e datës 24 janar me objekt Urdhër Mbrojtjeje, Gjyqtarja e çështjes, duke iu referuar vendimit të gjykatës është shprehur gjatë seancës gjyqësore: “*Kush do të të mbrojë, kjo copë e letrës?*”.

Konkluzione: Për mbarëvajtjen e procesit, ka nevojë që gjyqtari të jetë i aftë për të mbajtur në vëmendje dhe kontroll të gjithë sallën e gjyqit.



Është e nevojshme që ai të ketë një ton zotërues për sallën, zë dhe fjali të qarta, si dhe të jetë i kuptueshëm për palët.

Në të gjitha rastet, Gjyqtari duhet t’i kushtojë rëndësi qetësisë dhe rregullit në sallën e gjyqit.

Në të gjitha rastet, Gjyqtari duhet të transmetojë besueshmëri ndaj gjykatës, procesit gjyqësor dhe vendimit të gjykatës.


3. Përdorimi i njohurive dhe gjuhës juridike.

Ky aspekt paraqitet disi kompleks. Përdorimi i një gjuhe të edukuar dhe jo vulgare është mjaft i rëndësishëm në proces, por ai nuk mjafton për etikën gjatë seancave gjyqësore. Nga ana tjetër, gjyqtari duhet të përdorë njohuritë e tij juridike dhe njëkohësisht duhet të forcojë mjeshtërinë e tij për të qenë i qartë jo vetëm për avokatët por edhe për palët. Matja e këtij treguesi ka qenë i vështirë në monitorim, megjithatë ne e kemi lidhur me disa aspekte që mund të shërbejnë për të nxjerrë mësim. Konkretisht, përgatitëm disa pyetje në skedën e monitorimit, nga plotësimi i të cilave rezulton sa vijon:

Grafiku. 11. -A e përdori Gjyqtari së tepërmi gjuhën teknike ligjore?**Grafiku. 12 -A ishte toni dhe veprimet e Gjyqtarit, profesionale?**

Nga monitorimi i seancave gjyqësore, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka rezultuar se në 3 raste nga 69 seanca gjyqësore të monitoruara, toni i gjyqtarit nuk ka qenë profesional ndaj viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare.

Grafiku. 12.1-A ishte toni dhe veprimet e Gjyqtarit, profesionale?



Konkluzione dhe sugjerime. Gjuha teknike dhe ligjore është e nevojshme të përdoret, pasi ajo lidhet edhe me solemnitetin e seancës gjyqësore, por jo deri në masën sa procesi të bëhet i pakuptueshëm.

VII. PËRMBLEDHJE E SUGJERIMEVE KRYESORE.

- Sugjerohet përcaktimi i tarifave për shërbimin e psikologut duke mbajtur parasysh edhe të ardhurat e palëve, përveç kriterëve të tjera.
- Të zbatohet vendimi i Gjykatës Kushtetuese dhe të hartohen komentare për zbatimin e këtij vendimi nga gjykatat, me qëllim që ato të shërbejnë për të gjithë praktikën gjyqësore.
- Të rriten mundësitë për bashkëpunimin e OJF-ve me Komisionin shtetëror të Ndhmës Juridike me qëllim zbatimin efektiv të ligjit "Për ndihmën Juridike".
- Të bëhet ministudim mbi efektivitetin e legjislacionit aktual mbi taksat gjyqësore në RSh dhe të vlerësohet ky legjislacion në lidhje me mundësitë që ofron për përjashtimet dhe lehtësimet tatimore të shtetasve nga taksat gjyqësore. Nga rezultatet e ministudimit të përgatiten paketat e nevojshme për ndryshim.
- Sugjerojmë të rishikohet Sistemi i vlerësimit profesional dhe etik të gjyqtarëve, duke mbajtur parasysh jurisprudencën më të re në këtë fushë. Kjo detyrë duhet të kryhet nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë.
- Krijimi dhe institucionalizimi i rrjetit të psikologëve dhe punonjësve socialë që do të ndihmojnë me ekspertizë procesin gjyqësor. Kjo detyrë duhet të kryhet nga Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Gjykatat, Ministrinë që ndjek çështjet sociale dhe organizatat e shoqërisë civile.
- Vendosja e tarifave për shërbimin e psikologut dhe të punonjësit social në proceset e zgjidhjes së martesave. Të parashikohen rastet kur ky shërbim duhet të jepet falas. Kjo detyrë duhet të kryhet nga Ministria e Drejtësisë dhe Këshilli i Ministrave. Udhëzimi ekzistues i Këshillit të Ministrave Nr. 4, datë 12.12.2012, për caktimin e masës së shpenzimeve dhe pagesave të ekspertëve dhe dëshmitarëve gjatë procesit gjyqësor, ka nevojë për plotësime lidhur me këtë ekspertizë. Ose mund të ketë një udhëzim të ri vetëm me këtë objekt.
- Vendosja e kërkesave dhe standardeve për psikologët dhe punonjësit socialë që do të japin ekspertizë në gjykatë. Trajnimi i tyre. Kjo, është detyrë e ministrisë së Drejtësisë, në bashkëpunim me ministrinë e çështjeve sociale.

- Krijimi dhe institucionalizimi i rrjetit të avokatëve që do të ndihmojnë me ndihmë ligjore falas, viktimat e dhunës në familje në proceset gjyqësore për lëshimin e urdhrave të mbrojtjes. Kjo detyrë duhet të kryhet nga Komisioni Shtetëror i Ndihmës juridike dhe Dhoma Kombëtare e Avokatisë, në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë.
- Të përmirësohen trajnimet dhe shkëmbimet e përvojave me qëllim një dukje dinjitoze e gjykatës së paanshme. Kjo detyrë kryhet nga Shkolla e Magjistraturës.
- Të përmirësohen standardet dhe kërkesat për avokatët, me qëllim që të njohin mirë sjelljen e avokatit në proceset gjyqësore dhe atë të gjyqtarit, në kuadrin e parimit gjykatë e paanshme. Kjo detyrë kryhet nga e Dhoma Kombëtare e Avokatisë.
- Të shtohen dhe të përmirësohen studimet në këtë fushë, për të gjykuar më mirë mbi parametrat e institutit të heqjes dorë të gjyqtarit në rastet kur ka dyshime për anshmëri. Kjo bëhet me qëllim që të mos cenohen afatet e gjykimit dhe thelbi i vetë procesit gjyqësor. Kjo detyrë kryhet nga gjykatat, Shkolla e magjistraturës, Këshilli i Lartë i Drejtësisë.
- Të rishikohet mënyra e zbatimit të nenit 174 të Kodit të Procedurës Civile dhe të realizohet mundësia e palëve për të njoftuar prezencën, ose të ndryshohet ligji në mënyrën më efektive.
- Të krijohen ambiente të përshtatshme për avokatët që presin, me qëllim që ata të marrin njoftim të sigurtë për fillimin e seancave gjyqësore.
- Të krijohen ambiente të përshtatshme për palët që presin, me qëllim që ata të marrin njoftim të sigurtë për fillimin e seancave gjyqësore.
- Thirrja e palëve për fillimin e procesit gjyqësor në korridoret e Gjykatës të jetë i kuptueshëm dhe të komunikohet emri i gjyqtarit, si dhe ambienti ku do të zhvillohet gjykimi.
- Të bëhet kujdes për përpunimin e të dhënave në database, me qëllim që ato të japin të saktë orën dhe fazat e zhvillimit të seancës.

- Mendojmë se gjykata duhet të riorganizojë njoftimet në mënyrë të tillë që avokati dhe pala të kenë më shumë se një alternativë njoftimi.
- Mendojmë se thirrja e palëve për UMM duhet të ketë një më shumë se një alternativë të sigurtë.
- Gjyqtarët duhet ta respektojnë rregullin për të qëndruar me uniformë gjatë procesit gjyqësor.
- Duhet të ndalohet kategorikisht përdorimi i celularit gjatë seancave gjyqësore.
- Të bëhet rregull një periudhë pushimi pas çdo seance gjyqësore, me qëllim që gjyqtarët të përfundojnë komunikime të ndryshme jashtë seancave ose urgjenca personale.

Bibliografia:

Studime e Monografi:

- “Drejt Drejtësisë. Analizë e procesit civil në gjykatat e rretheve gjyqësore”, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, prezenca në Shqipëri.
- Komisioni Europian, *Progres raporti 2012 për Shqipërinë*, Bruksel, më 10.10.2012
- Sokol Sadushi, “Drejtësia Kushtetuese në zhvillim”, Shtwpia Botuese Toena, Tiranë, 2011.
- Kristi Danilet, “Korrupsioni dhe antikorrupsioni në sistemin e Drejtësisë”, Konrad Adenauer 2009, (përkthyer në shqip dhe botuar në http://www.kas.de/ef/doc/kas_22459-1522-33-30.pdf?110526130640, vizituar për herë të fundit më 12.08.2013.
- Komiteti Shqiptar i Helsinkit, “Raport për monitorimin e rregullshmërisë së proceseve gjyqësore”, botuar në faqen zyrtare: http://www.ahc.org.al/site/doc/Raport_gjyqesor_shkurt%202012.pdf, vizituar për herë të fundit, më 26.08.2013
- TLAS, Raport Mbi Ndihmën Juridike në Shqipëri, me mbështetjen e Civil Rights Defenders, Tirane 2012,

Artikuj studimorw dhe kumtesa.

- Aurela Anastasi, “Mekanizmat për dëmshpërblimin e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore dhe rëndësia e forcimit të tyre”, në “Jeta Juridike”, Nr. 2, Dhjetor 2009.
- Flutura Kola -Tafaj, “Pavarësia dhe paanshmëria e gjyqësorit”, në “Jeta Juridike”, Nr.1, mars, 2010
- Rezarta Mataj, *Shpenzimet gjyqësore në procesin civil*, revista “Jeta Juridike, nr. 1, Viti 2013
- Selim Kryeziu, “Etika e gjyqtarit, në “Revista Juridike”, nr.2, dhjetor 2005.
- Josep Casadevall Medrano, “Gjykatë e pavarur dhe e paanshme”, kumtesë e mbajtur në Konferencën “Reforma gjyqësore, si një ndër 12 prioritetet e sfidës së integritetit të Shqipërisë në BE”, Tiranë, Korrik, 2012., fq.101.
- Arta Vorpsi, “Korrupsioni në sistemin e drejtësisë dhe strategjitë antikorrupsion”, botuar në “Reforma Gjyqësore si një ndër 12 prioritetet e sfidës së integritetit të Shqipërisë në BE”, Tiranë, Korrik, 2012,

- Gent Ibrahimi, *Transparenca e gjykatave dhe vlerësimi i gjyqtarëve si instrumente për garantimin e besueshmërisë dhe pavarësisë së gjyqësorit*, kumtesë e botuar në “Reforma gjyqësore si një ndër 12 prioritetet e sfidës së integritetit të Shqipërisë në BE”, Tiranë, Korrik, 2012”.

Dokumente:

- “Përmbledhje e vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”, Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare, nëntor 2009,
- Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut të Këshillit të Evropës, Rezoluta për etikën gjyqësore, Shkurt 2013, paragrafi 3.
- Sistemi i vlerësimit profesional dhe etik i gjyqtarëve dhe Vendimi i KLD-së Nr.199/3, dt. 15.09.2006, “Mbi kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”.

Aneks I. Aktivitete

**Foto nga tryeza përmbyllëse me temë:
“Çështje të rritjes së efektivitetit, transparencës dhe të besimit të publikut ndaj
organeve të pushtetit gjyqësor”,
organizuar në Tiranë më 03.12.2013**



Pjesëmarrës:

Manjola Bejleri – Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë
 Arta Vorpsi – Gjykata Kushtetuese
 Valbona Pajo – Gjykata Kushtetuese
 Vojsava Osmanaj – Këshilli i Lartë i Drejtësië
 Hajrie Muçmataj - Këshilli i Lartë i Drejtësië
 Elona Hoxha – Ministria e Drejtësië
 Ermira Shtino – Ministria e Drejtësië
 Olsi Kristo - Ministria e Drejtësië
 Brunilda Dervishaj – Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë
 Mariana Semini – Shkolla e Magjistraturës
 Flutura Kola Tafaj- Fakulteti i Drejtësisë
 Vjollca Meçaj – Komiteti Shqiptar i Helsinkit
 Elton Frashëri - Komiteti Shqiptar I Helsinkit
 Ines Leskaj- AWEN
 Bukurie Imeri – Shoqata “GDI”
 Adelajda Demo – Shoqata “Të ndryshëm dhe të barabartë”
 Edva Mara - Shoqata “Të ndryshëm dhe të barabartë”
 Besmira Braka – Studio ligjore “Braka”
 Eranda Ndregjoni – Qendra Aleanca Gjimore për Zhvillim
 Erjona Mulellari – Qendra Aleanca Gjimore për Zhvillim
 Alba Agolli – Refleksione
 Majlinga Angoni – Gruaja tek Gruaja
 Atila Uligaj - Gruaja tek Gruaja
 Drita Babameto – Qendra për zhvillimin e grave rurale
 Elona Ocka – Linja e këshillimit për gra dhe vajza
 Rrahime Brahimetaj – Qendra Komunitare “Sot për të ardhmën”
 Drilona Koldashi - Qendra Komunitare “Sot për të ardhmën”
 Iris Spahiu – skuadra probono QNL
 Elba Arapi - skuadra probono QNL
 Elton Zeneli - skuadra probono QNL
 Griselda Muça - skuadra probono QNL
 Kristi Xhemalaj - skuadra probono QNL
 Sajmira Kopani - skuadra probono QNL
 Jay Carver – USAID/ JUST
 Lisina Mano – Projekti JUST
 Elvana Gadeshi – Projekti JUST